

Koalicioni i OJQ-ve “Të gjithë për gjykim të drejtë”  
Misioni i OSBE-së në Shkup

Natali Petrovska, **avokate**  
Doc.d-r Boban Misoški, Fakultetit Juridik “Justinianus Primus”, Shkup

# ANALIZË E TË DHËNAVE NGA MONITORIMI PROCEDURAVE GJYQËSORE NË VITIN 2016

Natali Petrovska, avokate

Doc.d-r Boban Misoski, Fakultetit Juridik “Justinianus Primus”, Shkup



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Misioni në Shkup**

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

Shkup, dhjetor 2016

## ■ HYRJE

Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” është rrjet që përbëhet nga 14 organizata qytetare ku bëjnë pjesë shoqata qytetare të vendit, dhe ka për qëllim ndjekjen e proceseve gjyqësore para gjykatave kompetente që të sigurohen të drejtat e garantuara për gjykim të drejtë, ashtu siç është paraparë me Kushtetutë, me ligjet dhe me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, të rritet vetëdija publike, të potencohet nevoja për reforma dhe të punohet në reformat e mundshme në procedurat gjyqësore, të shtohen njohuritë praktike të studentëve të drejtësisë dhe të përforcohet roli dhe kapaciteti i organizatave joqeveritare.

Për shkak të nevojës gjithnjë e më aktuale për ndjekje të lëndëve gjyqësore, e posaçërisht në fushën e të drejtës penale, gjegjësisht procedurës penale, Koalicioni, gjatë vitit 2016, me mbështetjen financiare të Misionit të OSBE-së në Shkup, e realizoi projektin “Përforcimi i pavarësisë, transparencës dhe efikasitetit të gjyqësisë nëpërmjet monitorimit të procedurave gjyqësore”, i cili paraqet vazhdim të aktiviteteve vëzhguese nga viti i kaluar. Theksi u vendos në zbatimin e Ligjit të ri për procedurë penale, në të gjitha katër rajonet e apelit në vend, më saktë nëpër gjykatat themelore të vendit, me qëllim të përgatitjes së analizës për gjendjet, e cila do të përmbajë rekomandime për aktivitetet e ardhshme dhe domosdoshmërinë për reforma, me qëllim që të përforcohen kapacitetet e sistemit gjyqësor në vend.

## ■ METODOLOGJIA

### *Vëzhguesit*

Për nevojat e këtij projekti dhe për përgatitjen e analizës si produkt final nga të dhënat që janë në dispozicion, të cilat dolën nga ndjekja e procedurave gjyqësore, u angazhuan 15 vëzhgues me përvojë shumëvjeçare në vëzhgimin e procedurave gjyqësore në vend. Që t’i përcaktonin sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohen gjykatat dhe të gjithë pjesëmarrësit në procedurën penale, mirëpo edhe që të vërenin implementim joadekuat, gjegjësisht jo të plotë të Ligjit për procedurë penale, duhej që ata të kenë arsim të lartë, më konkretisht, studime të kryera juridike dhe njohje solide të materies penale, e veçanërisht të procedurës penale.

### *Pyetësi*


Në procesin e mbledhjes së të dhënave nga ndjekja e bërë, vëzhguesit kishin në dispozicion mjet - pyetësor, sipas të cilit udhëhiqeshin nëpër sistemin për përpunimin e informatave dhe përshtypjeve fillestare, që i fitonin gjatë prezencës së tyre nëpër gjykata. Konkretisht, pas informatave të plota të fituara fillimisht gjatë një shqyrtimi, në bazë 72 pyetjeve të sistematizuara në mënyrë precize në pyetësor, ata i fushin të dhënat e mbledhura në masën dhe mënyrën që do t’i shërbente nevojave të kësaj analize. Pyetësi u përgatit në përputhje me renditjen dhe udhëheqjen e procedurës penale para gjykatave kompetente, me theks në disa nga institutet e reja, gjegjësisht risitë e futura në Ligjin për procedurën penale, e kuptohet duke lënë edhe hapësirë të përshtatshme për ta shënuar perceptimin kognitiv personal nga ana e vëzhguesve.

## ■ TË DHËNA TË PËRGJITSHME

Në kuadër të këtij projekti, sistemi i vëzhgimit ishte i shpërndarë në territorin e gjithë vendit, gjegjësisht në katër zona të apelit, me atë që theksi u vendos në gjykatat në Shkup (Gjykata themelore Shkup 1), Veles, Manastir, Shtip, Tetovë, Kumanovë dhe Koçanë, ndërsa si synim ishin 450 shqyrtime gjyqësore, gjegjësisht 372 lëndë penale.


Nga ky numër i përgjithshëm, në Gjykatën themelore Shkup 1, Shkup, u ndoqën 198 shqyrtime, gjegjësisht 152 lëndë, në Gjykatën themelore në Veles 33 shqyrtime dhe po aq numër i lëndëve, në Gjykatën themelore në Kumanovë u ndoqën 14 shqyrtime që kishin të bëjnë me 12 lëndë, në Gjykatën themelore në Tetovë u vëzhguan 71 shqyrtime që ishin si rezultat i 57 lëndëve, në Gjykatën themelore në Manastir, numri i shqyrtime të ndjekura është i përafërt me numrin e përgjithshëm të lëndëve të vëzhguara, në Gjykatën themelore në Shtip ky numër ishte 29 shqyrtime që kishin të bëjnë me 23 lëndë dhe në fund në Gjykatën themelore në Koçanë numri i shqyrtime të ndjekura poashtu në masë të madhe përputhet me numrin e lëndëve, gjegjësisht 16 shqyrtime për 15 lëndë. Pasqyrë tabelare të kësaj statistike është dhënë në tabelën e mëposhtme.

**Statistika nga numri i shqyrtimeve të vëzhguara kundrejt numrit të lëndëve**




Duke pasur parasysh faktin se në fazën e fillimit të këtij projekti, filloi edhe procesi i grevës së administratës gjyqësore, i cili zgjati pothuajse sa gjysma e periudhës së paraparë për vëzhgim, edhe vetë dinamika e vëzhgimit nuk ishte konstante, gjegjësisht ndryshonte, me ç'rast numri më i madh i vëzhgimeve u realizua pas përfundimit të grevës. Në fakt, sikurse edhe në vetë paraqitjen tabelare të dhënë më poshtë, mund të vërehet se në 3 muajt e fundit të procesit të vëzhgimit ka numër më të madh të shqyrtimeve të vëzhguara, gjegjësisht në shtator - 85, në tetor - 91 dhe në nëntor - 161 shqyrtime, (pasqyrë tabelare të kësaj statistike është dhënë në tabelën e mëposhtme). Mirëpo, ajo që bie në sy është trendi i mbajtjes së shqyrtime gjatë periudhës së grevës së administratës gjyqësore në Gjykatën themelore Shkup 1 në Shkup. Edhe pse në gjykatat e vendit kishte ngecje të punës, në pjesën më të madhe të tyre aspak edhe nuk janë mbajtur shqyrtime, respektivisht kishte bllokadë të plotë, në Gjykatën themelore Shkup 1 kjo nuk ndodhi. Në këtë gjykatë një pjesë e gjykatësve punonin, gjegjësisht i mbanin shqyrtimet e caktuara, ndërsa një numër i vogël i tyre u solidarizuan me administratën dhe nuk punonin fare, edhe pse duhet të potencojmë se bëhej fjalë për një numër të vogël të gjykatësve.

### Shqyrtimet sipas muajve



Nga të dhënat e mbledhura nga gjykatat e vendit, gjegjësisht nga numri i përgjithshëm i shqyrtimeve që u vëzhguan,  $\frac{1}{3}$  e tyre apo 153 seanca janë prolonguar, 119 prej tyre kanë përfunduar me aktgjykim, në 9 raste është tërhequr aktakuza, në vetëm 1 seancë është ndërprerë procedura penale, ndërsa 168 kanë vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve të procesit në to, nga duket qartë edhe në grafikonin e mëposhtëm. Realisht, ky numër është për t'u habitur, veçanërisht nëse merret parasysh fakti se në dy zonat më të mëdha të apelit, në Shkup dhe Manastir, numri i shqyrtimeve të prolonguara është dukshëm më i madh se sa në zonat e tjera.

### Statistika e veprimeve të procesit sipas gjykatave



Sipas të dhënave, ky prolongim i shqyrtimeve është rezultat i më tepër rrethanave të parapara edhe në vetë ligjin për procedurë penale, mirëpo edhe jashtë tij. Në fakt, problemet e natyrës së dërgimit jo të rregullt, mosparaqitjes në shqyrtimet gjyqësore të palëve të procedurës, mirëpo edhe të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, mbeten si temë që patjetër duhet të shqyrtohet, me qëllim të avancimit dhe të përmirësimit të sistemit për sigurimin e prezencës së pjesëmarrësve të domosdoshëm në procedurë. Nga të dhënat e analizuar vijnë deri te statistika se në masë të madhe prolongimi i shqyrtimeve është rezultat i mungesës së të akuzuarit në procedurë – në 97 raste,


gjegjesisht shqyrtime, pastaj i prokurorit publik – 32 raste, i mbrojtësit - 26 raste, mirëpo edhe i përbërjes jo të plotë të ekipit gjyqësor të caktuar për shqyrtimin e lëndës konkrete - 4 raste, ndërsa nuk është për t'u nënçmuar as numri prej 53 shqyrtimeve që janë prolonguar për arsye “të tjera”.

Si njëra nga arsyet për mosardhjen e të akuzuarit në shqyrtim është theksuar edhe mosshoqërimi i tyre nga institucionet ndëshkuese-përmirësuese. Në disa raste kjo është rezultat i moskoordinimit me sistemin për evidencë të shoqërimit të personave të privuar nga liria, në disa raste pamundësia teknike (e cila gjithsesi është e lidhur me mjetet financiare) që i akuzuari të silltet në gjykatë – kur bëhet fjalë për gjykime në qytete jashtë zonave ku gjenden institucionet ndëshkuese-përmirësuese, ndërsa në raste të tjera edhe përputhja e kohës me lëndë të caktuara gjyqësore të profilit të lartë, për shkak të të cilave i gjithë sistemi i zonës së caktuar gjyqësore (në këtë rast i Gjykatës themelore Shkup 1, Shkup) praktikisht është i bllokuar dhe nuk funksionon.

Dispozitat ligjore për mungesën e përfaqësuesit të aktakuzës, gjegjesisht paditësit privat, qartë tregojnë se prezenca e tij në procedurë është e domosdoshme, mirëpo edhe përkundër këtij fakti, prokurorët publikë kanë munguar në 32 raste, gjegjesisht në 32 shqyrtime, që paraqet një përqindje të lartë prej 20% si arsye për prolongim nga numri i përgjithshëm i lëndëve të prolonguara. Me këtë numër ndërlidhet edhe numri prej 26 shqyrtimeve në të cilat ka munguar mbrojtësi i të akuzuarit. Arsye më e shpeshtë për këtë fakt është ndryshimi i mbrojtësve nga ana e të akuzuarve dhe sinkronizimi i tyre me obligimet e caktuara më parë në lëndë të tjera, mirëpo edhe domosdoshmëria për t'u njoftuar me faktet dhe provat e lëndës, gjë që padyshim kërkon kohë. Dhe në fund, si shkak për prolongim që është shënuar në kategorinë “të tjera”, më shpesh është mungesa e dëshmitarëve ose e ekspertëve në procedurë, mirëpo edhe nevoja për prezantimin e ndonjë prove që nuk është siguruar ose ekspertize e cila akoma nuk është përgatitur. Në këtë rast konkret, nën kategorinë “të tjera”, janë prolonguar gjithsej 53 shqyrtime.

Në paraqitjen e mëposhtme tabelore janë dhënë prolongimet e shqyrtimeve gjyqësore sipas qyteteve dhe arsyet më të shpeshta për këtë. Siç e potencuam, ky është edhe njëri nga problemet më të hidhura të gjyqësisë që është duke zgjatur me vite të tëra. Ajo që mund të nxirret si përfundim nga ky grafik është fakti se numri i prolongimeve është në proporcion të drejtë me madhësinë e qyteteve ku është bërë monitorimi, dhe kështu, në Shkup dhe në Manastir arsyet për prolongim janë më të shumta, gjegjesisht janë shfrytëzuar të gjitha opsionet e ofruara në pyetësor, për dallim nga qytetet më të vogla, si për shembull Velesi dhe Koçani. Ajo që bie menjëherë në sy është mungesa e të akuzuarit si arsye për prolongim të shqyrtimit edhe në Shkup edhe në Manastir, që është e qartë edhe nga tabela e mëposhtme, mirëpo edhe mungesa e prokurorit publik (si përqindje më tepër në Shkup).


### Shkaqet e prolongimit sipas qyteteve



Duke i pasur parasysh të dhënat nga vëzhgimi i realizuar gjatë vitit të kaluar, të dhënat e sivjetme nuk tregojnë ndonjë trend të rritjes, përkundrazi edhe vitin e kaluar edhe këtë vit, statistikisht,  $\frac{1}{3}$  e shqyrtimeve të monitoruara prolongohen, që do të thotë se prolongimi i shqyrtimeve gjyqësore është një problem serioz që nuk duhet të lihet pas dore, përkundrazi, duhet të gjenden zgjidhje ligjore që do ta avancojnë procedurën me mekanizma për parandalim. A do të bëhet kjo nëpërmjet bashkëpunimit më të mirë të organeve gjyqësore me ato që janë kompetente për shoqërimin e personave të privuar nga liria, për shkak se jo rrallë, mungesa e të akuzuarve në procedurë nuk është faj i gjykatës, apo ndoshta me anë të zbatimit më konsekuent të dispozitave që kanë të bëjnë me sanksionet për mosardhjen e palëve në procedurë, në rastin konkret të prokurorisë publike, mirëpo sidoqoftë është më se e qartë se nevojiten zgjidhje më të mira.

Sipas të dhënave të fituara nga vëzhgimi i realizuar, në 450 nga numri i përgjithshëm i shqyrtimeve të ndjekura, veprat më të shpeshta penale që janë kryer kanë të bëjnë me kapitullin “Vepra penale kundër pronës”, mirëpo edhe nga kapitulli “Vepra penale kundër jetës dhe trupit”, si dhe “Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik”. Vepra më të shpeshta penale janë “Vjedhje e rëndë”, dhe “Vjedhje” në 60, gjegjësisht 38 nga shqyrtimet e vëzhguara, e pastaj vepra “Lëndim trupor” në 40 nga shqyrtimet e vëzhguara, “Rrezikim i sigurisë” në 20 shqyrtime, mirëpo edhe “Rrezikim i sigurisë në komunikacion” në 23, gjegjësisht “Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në komunikacion”, në 22 shqyrtime të vëzhguara.


## Numri i veprave penale



Në gjithsej 450 shqyrtime të vëzhguara gjatë këtij viti, vëzhguesit kanë evidentuar gjithsej 815 të akuzuar të cilët janë paraqitur, si në lëndë në të cilat ka nga një të akuzuar, ashtu edhe në lëndë me më tepër të akuzuar, duke arritur kështu në numrin prej 37 të akuzuarve për një lëndë.




### Numri i shqyrtimeve dhe i të akuzuarve në to




E drejta për mbrojtës në LPP është paraparë në nenin 71, gjegjësisht në nenin 74 të tij. Në fakt, ligji parasheh se çdo person i dyshuar ose i akuzuar për veprë penale, ka të drejtë për mbrojtës gjatë gjithë procedurës penale kundër tij. Me këtë rast, i akuzuari para marrjes së parë në pyetje ose para ndonjë veprimi tjetër që është paraparë me LPP, duhet të këshillohet se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, me të cilin mund të këshillohet, mirëpo edhe mbrojtësi të marrë pjesë gjatë marrjes së tij në pyetje. Mirëpo, në rastet kur i akuzuari është memec, i shurdhër ose i paafte që vetë të mbrohet me sukses ose nëse kundër tij zhvillohet procedurë penale për veprë për të cilën në ligj është paraparë dënim me burg të përjetshëm, ai patjetër duhet të ketë mbrojtës që në marrjen e parë në pyetje. Domosdoshmërinë për të pasur mbrojtës, ligji e parasheh edhe në rastet kur është paraparë, gjegjësisht kur është përcaktuar masa e paraburgimit, edhe atë gjatë kohës sa zgjat paraburgimi. Në qoftë se vjen në situatë që përsëri mbrojtja të jetë e domosdoshme, ndërsa i akuzuari nuk merr mbrojtës, atëherë kryetari i gjykatës do t'i caktojë atij mbrojtës sipas detyrës zyrtare për rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës, deri sa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Nga të dhënat e mbledhura gjatë procesit të vëzhgimit erdhëm deri te kjo statistikë: kundrejt numrit prej 276 të akuzuarve që kishin angazhuar mbrojtës të tyre, për 38 të akuzuar janë caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare, ndërsa 108 të akuzuar fare nuk kanë pasur mbrojtës.


### Numri i shqyrtimeve ku i akuzuari ka pasur mbrojtës



### Numri i shqyrtimeve ku i akuzuari ka pasur mbrojtës sipas detyrës zyrtare




### Numri i shqyrtimeve ku i akuzuari nuk ka pasur mbrojtës



Ligji për procedurë penale parasheh 4 lloje të procedurave të shpejtuara edhe atë: 1) procedurë e shkurtuar e cila zbatohet në lëndët për të cilat është paraparë dënim me para ose dënim me burg deri në 5 vjet, 2) procedurë për sjellje të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes me prokurorin publik dhe të dyshuarin, ku është paraparë marrëveshje sa i përket sanksionit, 3) procedurë për ndërmjetësim ku merr pjesë një person i tretë i veçantë – ndërmjetësuesi dhe 4) procedurë për lëshimin e urdhërdënimit me të cilën propozohet dhe shqiptohet sanksioni i caktuar në rast se ekzistojnë prova të mjaftueshme për vepra penale që janë në kompetencë të gjykatësit individual. Duke pasur parasysh faktin se vëzhguesve të Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” u është mundur qasje dhe prezencë vetëm në procedurat që zhvillohen në gjykatë dhe për të cilat mbahen shqyrtime publike, ata kanë mundësi që përveç në procedurat e rregullta, të marrin pjesë vetëm një njëri nga procedurat e parapara të shpejtuara, edhe atë në procedurën e shkurtuar. Kështu, në bazë të të dhënave të mbledhura vijmë deri te numri prej 129 shqyrtimesh të mbajtura në procedurë të rregullt, numër ky që i përgjigjet 30% të shqyrtimeve të vëzhguara, dhe deri te numri prej 305 shqyrtimesh të mbajtura në procedurë të shkurtuar, që është 70% e shqyrtimeve të mbajtura.

### Lloji i procedurës




## SHQYRTIMI KRYESOR

Në bazë të ligjit për procedurë penale, pas përcaktimit nga ana e gjykatësit, gjegjësisht këshillit, se a janë të pranishëm në shqyrtimin kryesor të gjithë ata që janë të domosdoshëm për mbajtjen e saj, gjegjësisht se a mund të mbahet shqyrtimi edhe po qe se mungojnë disa nga personat e thirrur, gjykata e orienton shqyrtimin kryesor drejt mbajtjes së fjalimeve hyrëse. Ky proces fillon me radhë, me atë që mundësinë për të mbajtur fjalim hyrës e fiton paditësi – përfaqësuesi i aktakuzës, gjegjësisht i padisë private penale, e pastaj edhe mbrojtësi, gjegjësisht i akuzuari. Në këtë pjesë të procedurës, gjegjësisht me fillimin e zbatimit të këtij instituti, palët fitojnë mundësi që të paraqesin fakte vendimtare, të cilat kanë ndërmend t'i dëshmojnë, t'i prezantojnë provat që do t'i nxjerrin dhe t'i përcaktojnë pyetjet të cilat do t'i shqyrtojnë. Mirëpo, LPP-ja parasheh dallim në veprimin e gjykatës, e me këtë edhe në zbatimin e këtij instituti, kur bëhet fjalë për procedurën e rregullt në krahasim me procedurën e shkurtuar. Në fakt, kur bëhet fjalë për procedurën e rregullt, parimi i lartpërmendur i mbajtjes së fjalimit hyrës është rregull, me atë që mbrojtja gjithmonë ka të drejtë të mos mbajë fjalime hyrëse, mirëpo kur bëhet fjalë për procedurën e shkurtuar, e kjo është në mbi 80% të lëndëve gjyqësore duke pasur parasysh se përfshin vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg deri në 5 vjet, fjalimet hyrëse të përfaqësuesve të aktakuzës shndërrohen në prezantim të përmbajtjes së aktakuzës, ndërsa mbrojtja askund në ligj nuk është përfshirë me kontributin e saj në paraqitjen e fakteve vendimtare në dobi të mbrojtjes. Kështu, fjalimet hyrëse, edhe pse nuk janë të detyrueshme me ligj në procedurën e shkurtuar, shpeshherë dinë të përdoren edhe nga ana e mbrojtësve.

Nga të dhënat e përpunuara që dolën nga monitoringu, vijmë deri te numri prej gjithsej 122 fjalimeve hyrëse që janë mbajtur nga ana e prokurorit publik, 59 nga mbrojtësi dhe 37 nga vetë i akuzuari. Paraqitja tabelore e dhënë më poshtë tregon zbatimin e këtij instituti në procedurën e rregullt dhe atë të shkurtuar. Ajo që është specifike dhe që menjëherë mund të vërehet është se në disa raste gjatë procedurës së rregullt, mbrojtësit e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre që të mos mbajnë fjalim hyrës, më saktë në 7 lëndë të vëzhguara. Përkundër asaj se nuk është e paraparë – në procedurën e shkurtuar, në pothuajse 30% të rasteve, mbrojtësit megjithatë kanë mbajtur fjalime hyrëse.

Fjalimi hyrës



Vëzhguesit në kuadër të pyetësorit kishin për detyrë që, në bazë të perceptimit të tyre individual, të vlerësojnë se a mund të përcaktohet nga fjalimi i mbajtur hyrës se për cilat fakte vendimtare do

të flasë më pas dhe do t'i dëshmojë ato pala në procedurë që e mban fjalimin hyrës. Në bazë të kësaj janë mbledhur këto të dhëna:

- në 49% të shqyrtimeve, fjalimi hyrës i prokurorit publik ka qenë i qartë, në 23% i paqartë, ndërsa në 28% të fjalimeve hyrëse ka mundur pjesërisht të përcaktohet se çka paraqet dhe çka do të dëshmojë prokurori.

- në 77% të shqyrtimeve, fjalimi hyrës i mbrojtësit ka qenë i qartë, në 8% i paqartë, ndërsa në 15% të fjalimeve hyrëse ka mundur pjesërisht të përcaktohen faktet të cilat mbrojtja, gjegjësisht mbrojtësi do t'i dëshmojë

- në 35% të shqyrtimeve, fjalimi hyrës i paraqitur nga i akuzuari ka qenë i qartë, në 6% i paqartë, ndërsa në 59% të fjalimeve hyrëse ka mundur pjesërisht të përcaktohen faktet e të akuzuarit.

Nga të dhënat e fituara në këtë mënyrë padyshim mund të konstatohet se mbrojtësit e të akuzuarve janë më të qartë dhe më koncizë në fjalimet e tyre kundrejt prokurorëve publikë, kur bëhet fjalë për fjalimet hyrëse, mirëpo edhe se në përqindje të madhe faktet dhe provat pjesërisht të qarta të cilave iu referohen të akuzuarit tregojnë se është e domosdoshme të angazhohen njerëz profesionalë, në këtë rast mbrojtës, të cilët do t'i përfaqësonin interesat e tyre dhe të cilët, që në fillim të procedurës, gjykatës do t'i paraqesin një pasqyrë të qartë për qëllimet e tyre në aspekt të propozimit të provave dhe teorisë së rastit që do ta përfaqësojnë. Mirëpo, duhet theksuar se edhe një pjesë e këtyre fjalimeve hyrëse të të akuzuarve, sipas pyetësorëve të vëzhguesve, janë dhënë në prezencë të mbrojtësve të tyre.

Poashtu, patjetër duhet të potencohet jokonsekuenca e detektuar gjatë veprimit të prokurorëve publikë në aspekt të shndërrimit të asaj që do të duhej të ishte fjalim hyrës në lexim të thatë të aktakuzës, pa e paraqitur teorinë e rastit, gjegjësisht tezën që e përfaqëson, e aq më pak pa përcaktuar pyetje juridike të cilat do të shqyrtoheshin, me qëllim që të dëshmohet arsyeshmëria e aktakuzës. Nga të dhënat e përpunuara vijmë deri te statistika se në mbi 70% të rasteve ku është mbajtur fjalim hyrës nga ana e prokurorit publik, ai është shndërruar në lexim të aktakuzës, e jo në sqarim më të detajuar se çka do të ishte rezultati i saj. Me fjalimet e këtyra hyrëse, as gjykata nuk e ka të qartë se çka dëshmon prokurori, as mbrojtja nuk e ka të qartë tezën e prokurorit për arsyeshmërinë e akuzës dhe si planifikon ta dëshmojë atë.

## ■ PRANIMI I FAJIT

Nga seancat e ndjekura, vëzhguesit kanë qenë të pranishëm në 95 seanca në të cilat i akuzuar e ka pranuar fajin. Me këtë rast, këtu do t'i analizojmë të dhënat e fituara nga vëzhguesit sa i përket ligjshmërisë së pranimit të fajit, rolit të gjykatës dhe të palëve gjatë pranimit të fajit, si dhe disa rrethana të caktuara të pranimit të fajit në lidhje me disa institute specifike të procedurës penale që ndikojnë drejtpërdrejt mbi arsyeshmërinë dhe mbi ligjshmërinë e pranimit të fajit. Në këtë drejtim, do të analizohen të dhënat për zbatimin e paraburgimit gjatë shqyrtimeve ku është bërë pranimi i fajit, si dhe sasia e provave të të nxjerra nga ana e gjykatës gjatë marrjes së vendimit për caktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal në kushte kur është bërë pranimi i fajit gjatë seancës së parë të shqyrtimit kryesor.


Kështu në grafikun e treguar mëposhtë shihet trendi i pranimit të fajit, gjegjësisht nga gjithsej 450 seanca të vëzhguara, nga të cilat 153 kanë qenë të prolonguara, vëzhguesit kanë qenë të pranishëm në 95 seanca në të cilat është bërë pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit. Po të krahasohet me numrin e përgjithshëm të seancave të mbajtura (168) mund të përfundohet se të dhënat për pranimin e fajit nga i akuzuari paraqesin një informatë mjaft relevante për nxjerrjen e përfundimeve. Aq më tepër, kur merret parasysh se nga gjithsej 119 aktgjykime të analizuar, madje 95 janë sjellë nëpërmjet pranimit të fajit.

Pranimi i fajit dhe lloji procedurës penale			
	Procedurë e shkurtuar	Procedurë e rregullt	
Pranimi i fajit	78	14	92

Të dhënat e fituara në këtë mënyrë e gjenerojnë përfundimin se pranimi i fajit është i pranishëm dhe është institut që përdoret në sistemin nacional të të drejtës ndëshkuese. Bile, mund të përfundohet se ky institut, nga ana e subjekteve në procedurën penale, shihet si mjet efikas për përfundim të shpejtë, efikas dhe efektiv të procedurave penale. Si argument plotësues në aspekt të rritjes së përdorimit të këtij instituti mund të na shërbejë edhe informata nga lëndët e vëzhguara gjatë vitit të kaluar, ku janë vërejtur 70 lëndë të pranimit të fajit nga ana e të akuzuarit nga gjithsej 550 seanca të vëzhguara, për dallim nga sivjet kur kemi rritje prej më shumë se një e treta, gjegjësisht janë vërejtur 95 lëndë në të cilat i akuzuari e ka pranuar fajin në shqyrtimin kryesor nga gjithsej 450 seanca të vëzhguara.


Megjithatë, në qoftë se analizohen raportet vjetore të gjykatave themelore<sup>1</sup> do të vërehet se zbatimi i pranimit të fajit nuk është aq i madh sikurse te lëndët e vëzhguara, mirëpo qëndron përfundimi se ky institut përdoret gjithnjë e më shumë.

### Pranimi i fajit në procedurë të shkurtuar




Sa i përket zbatimit të këtij instituti, argument plus është edhe fakti se nga të dhënat e analizuara nga ana e vëzhguesve, ky institut në masën më të madhe, rreth 85% zbatohet në procedurën e shkurtuar, gjegjësisht për veprat penale për të cilat është e paraparë dënim me burg deri në 5 vjet. Kjo informatë e dëshmon tezën se gjykatat ndjehen të sigurta gjatë zbatimit të këtij instituti për veprat më të lehta penale, ndërsa në korrelacion me të dhënat nga raportet vjetore të gjykatave, si dhe me të dhënat e fituara nga vëzhguesit, fitohet përshtypja se ky institut nuk zbatohet aq shpesh për veprat më të rënda penale. Informata e këtyllë vetëm e vërteton faktin se bëhet fjalë për institut të ri, prandaj gjykatat, kuptohet, kanë rezerva të caktuara gjatë zbatimit të tij kur bëhet fjalë veprat më të rënda penale.

<sup>1</sup> Për shembull, shih Raportin vjetor për punën e Gjykatës themelore Shkup 1 për vitin 2015, që gjendet në: [http://osskopje1.mk/cms/FCKEditor\\_Upload/gizv15.pdf](http://osskopje1.mk/cms/FCKEditor_Upload/gizv15.pdf)



Sa i përket shpërndarjes gjeografike të institutit të pranimi të fajit në krahasim me numrin e përgjithshëm të seancave të vëzhguara, vërehet fakti se në përgjithësi pranimi i fajit është evidentuar në rreth një të pestën e seancave të vëzhguara, gjegjësisht rreth 20 për qind. Dallim nga ky trend ka në Gjykatën themelore Shkup 1 dhe në Gjykatën themelore në Tetovë. Kështu, në Gjykatën themelore Shkup 1 kemi numër më të vogël të seancave të vëzhguara në të cilat i akuzuari e ka pranuar fajin, gjegjësisht rreth 16 për qind nga numri i përgjithshëm i seancave të vëzhguara, ndërsa më shpesh pranimi i fajit është bërë në seancat e mbajtura në Gjykatën themelore të Tetovës, edhe atë në më shumë se një të tretën ose rreth 38 për qind të seancave të vëzhguara.


### Pranimi i fajit sipas VP



Sa i përket llojit të kriminalitetit për të cilin të akuzuarit kanë qenë të gatshëm ta pranojnë fajin, mund të vërehet se bëhet fjalë, në përgjithësi, për një diapazon të gjerë të veprave penale. Në krahasim me vjetarët statistikorë për lëvizjen e krimit<sup>2</sup>, kjo na mundëson ta nxjerrim përfundimin se të akuzuarit kanë qenë të gatshëm ta pranojnë fajin parimisht për të gjitha veprat penale, gjegjësisht trendi i pranimit të fajit e ndjek trendin e veprave penale për të cilat zhvillohen procedura para gjykatave themelore. Gjegjësisht, numër më të madh të pranimit të fajit ka për veprat penale kundër jetës dhe trupit, pronës dhe kundër sigurisë në komunikacionin publik. Pastaj për veprat penale kundër pozitës zyrtare dhe kundër moralit seksual dhe lirisë seksuale. Nga të dhënat e këtilla del përfundimi se pranimi i fajit të të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesor nuk varet nga lloji i veprës penale. Përfundimi i këtillë, në përgjithësi është pozitiv për shkak se nuk detekton përzgjedhje të pranimit të fajit sipas llojit të veprës penale. Në këtë drejtim, si përfundim plotësues imponohet teza se gatishmëria e të akuzuarve që ta pranojnë fajin varet nga fakti se në çfarë mase lënda dhe ngjarja juridike penale është hetuar nga organet e ndjekjes, gjegjësisht sa mirë është përgatitur aktakuza.

Grafikët e mëposhtëm kanë të bëjnë me analizën e rregullave procedurale për pranueshmërinë dhe ligjshmërinë e pranimit të fajit. Kështu, në përputhje me obligimin ligjor nga neni 74 i LPP-së për prezencën e detyrueshme të mbrojtësit gjatë pranimit të fajit nga i akuzuari, nga të dhënat e analizuarat të fituara nga vëzhguesit mund të përfundojmë se në të gjitha rastet ka qenë i pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit.

### A u parashtruan pyetje që të verifikohet pranimi fajit në aspekt të të gjitha karakteristikave të VP?




Sa i përket të dhënave për verifikimin e të gjitha karakteristikave të veprës penale, mund të përfundojmë se gjatë vlerësimit të pranimit të fajit, gjykatësit në masë të madhe ia kanë sqaruar të akuzuarit se për çka është i akuzuar, gjegjësisht për çka e pranon fajin. Megjithatë, akoma është e pranishme praktika, edhe pse me përmirësim minimal në krahasim me vitin e kaluar (87% në krahasim me 82%), se gjykatësit, të akuzuarve vetëm ua lexojnë aktakuzën, ose vetëm ua sqarojnë procesin e përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së sanksionit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së sanksionit penal. Prandaj, mund të përfundojmë se gjykatësit do të duhet t'i kushtojnë vëmendje më të madhe si të akuzuarit, ashtu edhe mbrojtësit të tij, në aspekt të kërkesës për dhënie të ndihmës adekuate juridike për klientët e tyre, gjatë sqarimit të esencës së veprës penale, provat me të cilat prokurori e mbështet esencën, si dhe mënyrën në të cilën është kryer vepra penale. Gjegjësisht, gjykata duhet të jetë plotësisht e bindur se i akuzuari e ka kryer pikërisht veprën penale që është shënuar në aktakuzë, respektivisht, pikërisht veprën penale të cilën i akuzuari e ka pranuar gjatë shqyrtimit kryesor. Kështu, nuk është e pranueshme praktika e gjykatës që vetëm ta lexojë aktakuzën, ose praktika e shënuar në njërin nga pyetësorët e vëzhguesve,

2 Shih: Vjetari statistikor për vitin 2015, gjendet në: <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=6>




ku i akuzuari ka thënë se e pranon fajin, mirëpo se vepra nuk është kryer në mënyrën në të cilën është shënuar në aktakuzë. Kundërshtimi i këtillë i të akuzuarit ose korrigjimi i aktakuzës nga ana e tij gjatë pranimit të fajit nuk guxon të pranohet nga gjykata si pranim vullnetar i fajit për veprën konkrete të shënuar në aktakuzë dhe gjykata duhet ta refuzojë atë dhe të vazhdojë me shqyrtimin kryesor sikur pranimi i fajit të mos jetë bërë fare, në kuptim të neneve 381 dhe 334 të LPP.

### A u parashtruan pyetje që të verifikohet se a është bërë pranimi fajit në mënyrë vullnetare?



Interesante është informata se vëzhguesit në 13% të seancave të vëzhguara në të cilat është bërë pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit kanë vërejtur jokonsekuencë në aspekt të pranimit vullnetar të fajit. Kjo do të thotë se në 11 raste i akuzuari nuk e ka pranuar fajin në mënyrë vullnetare apo ka pasur rezerva të caktuara, mirëpo gjykata këto rezerva nuk i ka marrë parasysh dhe e ka pranuar këtë pranim të mangët të fajit. S'ka nevojë të thuhet se praktika e këtillë e gjykatave duhet të çrënjësohet, veçanërisht nëse merret parasysh roli i gjykatës në procedurën për pranimin e fajit ose në procedurën për arritje të marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, ku ajo paraqitet si garantuese dhe mbrojtëse e të drejtave të të akuzuarit. Me praktikën e këtillë, vetëm stimulohet zbatimi i parregullt i pranimit të fajit dhe tolerohet taktika e paditësit të autorizuar për të gjetur autor të veprës, vetëm me qëllim që të procesohen lëndët nëpër labirintet gjyqësore, pa mbajtur llogari për atë se kush është autori i vërtetë i veprës penale, e as për mbrojtjen e drejtësisë.


### A u parashtruan pyetje që të verifikohet se a është i vetëdijshëm i akuzuari për pasojat e pranimit të fajit?



Në përqindje të njëjtë të rasteve vëzhguesit kanë vërejtur edhe mungesë të vetëdijes të akuzuarit në lidhje me pranimin e fajit. Me këtë rast, bëhet fjalë për rastet e detektuar nga ana e vëzhguesve ku gjykata aspak nuk i ka kushtuar vëmendje kundërshtimit të të akuzuarit gjatë pranimit të fajit, gjë që çon në përfundimin se në këto raste bëhet fjalë për pranim të detyrueshëm të fajit. Interesante është informata e vëzhguesve për një rast kur gjykata madje drejtpërdrejtë e

ka këshilluar të akuzuarin që ta pranojë fajin, me qëllim që të mos të ngritet aktakuzë ndaj një kushëriri më të rritur të afërt të tij, në emër të të cilit ka qenë i regjistruar matësi i rrymës elektrike, në rastin kur prokurori publik e ka akuzuar të akuzuarin për kryerje të veprës penale – vjedhje e rrymës elektrike sipas nenit 235-a nga KPM-ja. Kështu, në vend që në këto raste gjykatësit t'i mbrojnë interesat e drejtësisë dhe të jenë të paanshëm, në fakt ata kanë pasur qëndrim të formuar sa i përket fajit të të akuzuarit pa marrë parasysh mbrojtjen e tij, e as parimin e supozimit të pafajësisë së të akuzuarit. Me këtë rast, edhe përkundër përmirësimit të vogël të qartë në krahasim me vitin e kaluar, megjithatë, brengos fakti se akoma ekzistojnë raste të caktuara kur gjykata në vend që të jetë arbitër pasiv gjatë vlerësimit të aspektit vullnetar dhe të vetëdijes së të akuzuarit gjatë pranimit të fajit, ajo në mënyrë aktive i përfaqëson interesat e njëjës nga palët, edhe atë në kundërshtim me interesat e drejtësisë. Në këtë drejtim, imponohet përfundimi se ka nevojë për trajnim plotësues të gjykatësve me qëllim të mbrojtjes proaktive të drejtësisë në kushte kur është bërë pranimi i fajit gjatë shqyrtimit kryesor, gjegjësisht për rritjen e rolit të tyre aktiv gjatë vlerësimit të pranimit të bërë të fajit. Rol ky që është i ngjashëm me rolin e gjykatës në procedurën e përzier penale. Gjegjësisht, me qëllim që të përcaktohet se a e ka pranuar i akuzuari fajin në mënyrë të lirë dhe me vetëdije të plotë për të gjitha pasojat e tij, gjykata mundet dhe duhet të jetë aktive, e madje edhe inkuizitore gjatë vlerësimit të pranimit të fajit, me atë që madje mund të kërkojë edhe prova plotësuese apo deklarata nga i akuzuari me qëllim të zbardhjes së plotë dhe sqarimit të ngjarjes juridike penale e që të jetë e bindur se i akuzuari me të vërtetë është autor i veprës që e pranon<sup>3</sup>.

### A u nxorën prova pas pranimit të fajit?



Në fund, përveç verifikimit të aspektit vullnetar dhe të vetëdijes gjatë pranimit të fajit, gjykata duhet të vlerësojë se a është mbështetur pranimi i këtillë i fajit në mënyrë adekuate edhe me prova. Me këtë rast, në paragrafin 3 të nenit 381 të LPP-së, parashihet obligimi që gjykata të vlerësojë se a është mbështetur pranimi i fajit me prova, gjegjësisht gjykata gjatë shqyrtimit kryesor vetëm i prezanton provat që janë në dobi të përcaktimit adekuat të llojit dhe të lartësisë së sanksionit penal. Duke i pasur parasysh informatat e vëzhguesve, mund të përfundojmë se kjo pjesë e procedurës për vlerësim të pranimit të fajit nga i akuzuari është “më e lëndueshme” në aspekt të parandalimit të dëshmimeve të rrejshme.

Kështu, nga të dhënat bëhet e qartë se gjykata prezanton relativisht pak prova me të cilat do ta mbështeste pranimin e fajit, ndërsa aktgjykimin në masë më të madhe e bazon mbi dëshminë, gjegjësisht mbi pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit. Vëzhguesit vetëm në nëntë seanca të vëzhguara kanë vërejtur prezantim të provave me qëllim të përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së sanksionit

3 Shih: Misoski B., Iljk Dimoski D., Judges' Role in the Evaluation of the Defendant's Plea within the Sentence Bargaining Procedure, Journal of the Faculty of Security, Skopje, University St. Klement of Ohrid, Bitola, 2016.

penal. Me këtë rast, edhe më problematik është fakti se në gjysmën, gjegjësisht në 5 nga këto seanca, gjykata si provë e ka prezantuar vetëm atë që personi i akuzuar ka qenë i dënuar edhe më parë. Me këtë rast, nuk ka nevojë të elaborohet aspekti problematik i dënimit të mëparshëm si provë prima facie. Për arsye të thjeshtë se dënimi i mëparshëm<sup>4</sup>, vetvetiu nuk është arsye e mjaftueshme për ta përcaktuar mënyrën kriminale të jetës së një personi. Gjegjësisht, dënimi paraprak duhet të analizohet nga aspekti i llojit të veprës penale për të cilën ka qenë i dënuar më parë i akuzuari, kohës që ka kaluar prej dënimit të mëparshëm deri në momentin e pranimit të fajit dhe kuptohet, mënyrës së jetës së të akuzuarit gjatë kësaj periudhe. Diçka që thjeshtë nuk ka mundësi të caktohet nëpërmjet një operacioni të thjeshtë matematikor për llogaritjen e dënimit paraprak si nëntë pikë<sup>5</sup>, me qëllim që të fitohet dënim më i rreptë.

Në bazë të këtyre të dhënave, detyrimisht del përfundimi se gjykata patjetër duhet të ketë rol aktiv gjatë seancës së provës, gjegjësisht të ketë autorizim të kërkojë nga palët të prezantojnë prova në sasi dhe cilësi që janë të domosdoshme që gjykata të mund ta pranojë në tërësi pranimin e fajit nga i akuzuari si i rregullt dhe i drejtë, e pastaj edhe ta përcaktojë sanksionin adekuat. Shkaqet për prezantimin e këtyre të provave nuk gjenden vetëm te roli i gjykatës, por janë rezultat edhe i disa paqartësive në vetë LPP. Në fakt, në LPP është e paraparë se palët i propozojnë provat, ndërsa gjykata pasi ta pranojë pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit para vetes e ka vetëm listën e provave që do të prezantoheshin gjatë procedurës së provës për ta mbështetur aktakuzën (neni 321, paragrafi 2 i LPP). Kjo do të thotë se gjykata nuk e di dhe nuk mund ta dijë që më parë se ndonjëra nga provat e shënuara a do të shkojë në favor të pranimit të fajit ose jo, dhe në çfarë mase ndonjëra nga këto prova mund të kontribuojë për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal. Aq më tepër, ekziston edhe dilema se a do të kishte interes ndonjëra nga palët për zbardhje të plotë të provave nëpërmjet metodave voluminoze për marrje të drejtpërdrejtë dhe të kryqëzuar në pyetje të dëshmitarëve në kushte kur i akuzuari e ka pranuar fajin.


Mu për këtë, është e domosdoshme reformë e LPP-së edhe atë në drejtim të modifikimit të dispozitave me të cilat rregullohet shqyrtimi kryesor, me atë që do të pranohej zgjidhja burimore që ekziston në sistemin e të drejtës ndëshkuese të SHBA-ve, e ajo është mbajtja e seancës së veçantë për përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së sanksionit. Mu nëpërmjet kësaj seance do të evitohet dilema me të cilën ballafaqohen gjykatat e vendit, në përputhje me dispozitat aktuale të LPP-së, sipas të cilave nuk ka mjet efikas për prezantimin e provave për ta mbështetur pranimin e fajit dhe përcaktimin e sanksionit më adekuat, dhe për këtë arsye detyrimisht mbështetet vetëm mbi provat më të thjeshta, gjegjësisht mbi evidencën për dënimin e mëparshëm të të akuzuarit, si dhe mbi dispozitat edhe ashtu kontestuese<sup>6</sup> të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së sanksionit.

Në lidhje me pyetjen, *"A ka mbrojtësi kohë të mjaftueshme që ta këshillojë të akuzuarin?"*, vëzhguesit kanë pasur mundësi të vlerësojnë vetëm në një të tretën e seancave të vëzhguara në të cilat i akuzuari e ka pranuar fajin. Gjegjësisht në 29 prej 31 përgjigjeve, apo në 94% të rasteve, janë përgjigjur se i akuzuari ka pasur kohë të mjaftueshme të këshillohet me mbrojtësin e tij, ndërsa në 6% kanë konstatuar se i akuzuari nuk është këshilluar ose nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të këshillohet me mbrojtësin e tij.

4 Shih: Gruevska Drakullevski A., Recidivizmi dhe burgu, Grafoden, Shkup, 2016.

5 Sipas dispozitave të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimeve, Gazeta zyrtare nr. 199/2014.

6 Shih: Buzharovska G., Tupançeski N., Sentencing Guidelines, "Paradoksi i legjislacionit të Maqedonisë", Pravnik, nr. 238, Nëntor, 2015 Shkup.



Megjithatë, të dhënat e këtu nuk mund të problematizohen edhe aq shumë, për një arsye të thjeshtë, se nëse i akuzuari ka pasur mbrojtje edhe gjatë fazave të mëparshme të procedurës penale, mund të pritet se pranimi i fajit është dakorduar dhe është elaboruar që më parë me mbrojtësin e tij.


Problematiche do të ishte praktika nëse bëhet fjalë për raste kur i akuzuari nuk ka pasur mbrojtës, ndërsa ka vendosur ta pranojë fajin, dhe më pas ka angazhuar mbrojtës ose gjykata i ka caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare. Në këto raste konsiderojmë se gjykata patjetër duhet t'ua japë kohë të mjaftueshme të akuzuarit dhe mbrojtësit, me qëllim që mbrojtësi të mund t'ia sqarojë klientit të tij pasojat nga pranimi i fajit.

Aq më tepër, në qoftë se këto vërejtje në 6% të seancave bëjnë pjesë në këtë grup të rrezikut, atëherë praktika e këtillë e gjykatës do të duhej të çrrënjosej dhe nuk do të duhej të tolerohej nga asnjëra palë, pa marrë parasysh se sa do të ishte i favorshëm pranimi i fajit nga i akuzuari, si për të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, ashtu edhe për prokurorin publik. Për arsye të thjeshtë se kjo praktikë është kundërligjore dhe në kundërshtim me interesat e drejtësisë.

## ■ PARABURGIMI DHE MASAT PËR SIGURIMIN E PREZENCËS

Në Ligjin për procedurë penale, sipas nenit 144, janë paraparë këto masa për sigurimin e prezencës: ftesa, masat parandaluese, të garancisë, arrestimi, heqja e lirisë, mbajtja, paraburgimi afatshkurtër, paraburgimi shtëpiak dhe paraburgimi. Me këtë rast, nga kjo paletë e masave, vëzhguesit kanë qenë të pranishëm vetëm në 34 seanca në të cilat personat e akuzuar kanë qenë në paraburgim si në tabelën e mëposhtme, ndërsa masat më të lehta për sigurimin e prezencës së personit të akuzuar janë zbatuar vetëm në 14 raste.

A është caktuar paraburgim?



Nga të dhënat e fituara, mund të vërehet tendenca se nuk ka përdorim tepër të madh të paraburgimit nga ana e gjykatës në lëndët e analizuara që janë dokumentuar nga ana e vëzhguesve, gjegjësisht ky numër sillet në rreth 8 për qind të lëndëve të vëzhguara. Megjithatë, duke e pasur parasysh llojin e veprave penale të cilat janë vëzhguar gjatë seancave, mund të përfundojmë se paraburgimi nuk zbatohet në përqindje shumë të ulët ose të papërfillshme në krahasim me seancat e tjera. Me këtë rast, brengos fakti që është vërejtur nga ana e vëzhguesve se akoma vazhdon të ekzistojë praktika në gjykatë për të mos dhënë arsyetime adekuate për shkaqet për përcaktimin e masës së paraburgimit, e as vlerësimi real i faktorëve dhe theksimi i tyre në vendimet për vazhdimin e masës së paraburgimit nga ana e gjykatës<sup>7</sup>.

Përveç zbatimit të masës së paraburgimit, vëzhguesit kanë vërejtur se masat më të lehta për sigurimin e prezencës së të akuzuarit nga ana e gjykatës janë zbatuar vetëm në 26 raste (shih tabelën).

A ka sigurur masa të tjera për të suguaruar prezencën?							
	Ndalesë të lëshojë vendbanimin	Urdhër paraqitjeje në gjykatë	Marrja e pasaportës dhe paraqitja në gjykatë	Sjellja me forcë të akuzuarit	Sjellja me forcë e palës së dëmtuar	Sjellja me forcë e dëshmitarit	Gjithsejt
PO	1	6	1	6	1	1	26
JO							325
Gjithsejt	1	6	1	6	1	1	351

Vëzhguesit kanë vërejtur se këto masa në 14 raste janë përcaktuar për personin e akuzuar, në dy raste janë përcaktuar për pjesëmarrësit e tjerë në procedurën penale, gjegjësisht nga një herë është zbatuar sjellja e detyrueshme e të dëmtuarit dhe e dëshmitarit, ndërsa në 10 rastet e tjera bëhet fjalë për zbatimin e masës më të lehtë - ftesës.

Duke i pasur parasysh këto informata, si koment i patjetërsueshëm imponohet fakti se gjykata aspak nuk i merr parasysh masat të cilat mund të jenë alternativë e mirëfilltë për masën më të rëndë – paraburgimin, efikasiteti i të cilave është i pranuar në sistemet e tjera më të zhvilluara të të drejtës ndëshkuese.<sup>8</sup>

Në këtë drejtim, mbetet konstatimi se masat më të lehta paraqesin vetëm zbulim normativ në LPP-në tonë, dhe se zbatohen në raste jashtëzakonisht të rralla ose fare nuk zbatohen në praktikë. Për fat të keq, këtë fat e ndajnë masat e garancisë, paraburgimit shtëpiak dhe pjesa më e madhe e masave parandalueset. Në këtë drejtim, duhet të përmenden edhe argumentet për shkak të të cilave këto masa janë lënë pas dore, e kjo, në plan të parë, është kështu për shkak se nuk ka mekanizëm adekuat për zbatimin dhe kontrollin e tyre, e as që gjykata disponon me mjete adekuate të cilat do t'i ofronin të dhëna të mjaftueshme për të qenë e bindur se me të vërtetë gjatë zbatimit të tyre, gjykata do të ketë garanci të mjaftueshme se personi i akuzuar do të paraqitet në seancat e shqyrtimit kryesor dhe se nëpërmjet zbatimit të tyre me të vërtetë janë eliminuar ose janë zvogëluar rreziqet për shkak të të cilave këto masa edhe i janë përcaktuar personit të akuzuar.


7 Vërejtjet e këtylla një kohë të gjatë u janë dërguar gjykatësve të vendit, dhe ato u njohën edhe nga ana e Gjykatës së Strazburgut, si për shembull në lëndën "Vasillkovski dhe të tjerët kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", No. 28169/08, 28 tetor 2010. Për këtë, shih më gjerësisht edhe te: Buzharovska G., Andreevska S., Tumanovski A., Zbatimi i masës së paraburgimit sipas Ligjit për procedurë penale të vitit 2010 – analizë juridike, OSBE, Shkup, 2015.

8 Shih: Misoski B., Bail, precaution measures and/or house detention: analysis and recommendations for their more frequent use, Proceedings of the Post Doc Colloquium in Public Law, Tirana and Skopje, SEELS Network, 2014.

Mu për këtë, në këtë drejtim jepet rekomandimi që të zhvillohen mekanizma për mbështetje institucionale për gjykatën që t'i zbatojë masat më të lehta për sigurimin e prezencës së personit të akuzuar gjatë procedurës penale. Në këtë drejtim, këto mekanizma kryesisht i shohim duke i zhvilluar kapacitetet e Shërbimeve të provës, të krijuara në përputhje me Ligjin për shërbimin e provës, duke bërë ndryshime ligjore në Ligjin për shërbimin e provës për inkorporimin e këtyre masave në kompetencën e këtyre shërbimeve, si dhe zbatimin e LPP-së në atë aspekt që shërbimeve të provës t'u jepet obligimi që këto të dhëna t'ia japin gjykatës sipas detyrës zyrtare dhe të gjenerojnë vlerësime për rrezikun e personit të akuzuar, dhe në bazë të këtyre vlerësimeve gjykata do ta bazonte për zbatimin e masës më adekuate për sigurimin e prezencës së të akuzuarit. Në fund, nëpërmjet këtyre rekomandimeve, gjykata do të mund të japë arsyetim të bazuar në fakte për vendimet e saj me të cilat i zbaton masat për sigurimin e prezencës.


Në aspekt të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës për zbatimin e këtyre masave, mund të përfundojmë se përveç në një rast, në të gjitha rastet e tjera janë respektuar kërkesat e LPP-së për prezencë të mbrojtësit gjatë përcaktimit të paraburgimit të personit të akuzuar.

### Paraburgim-pa mbrojtës



Mirëpo, është për t'u përshëndetur praktika e analizuar nga ana e vëzhguesve (grafiku i mëposhtëm) kur gjykata në tërësi i ka plotësuar dispozitat e procesit për prezencë të detyrueshme të mbrojtësit në kushte kur personi i akuzuar që është paraburgosur e ka pranuar fajin për veprën e kryer penale.


### Pranimi i fajit me mbrojtës-paraburgim



Problematike është praktika e vërejtur (shih në grafiku e mëposhtëm) kur gjykata nuk ka vepruar në kuptim të nenit 173 të LPP-së, sipas të cilit, pas pranimit të fajit hiqet paraburgimi nëse ka qenë i përcaktuar për shkak të ekzistimit të rrezikut të bazuar se i akuzuari do t'i fshehë, do t'i falsifikojë ose do t'i shkatërrojë gjurmët e veprës penale ose nëse disa rrethana të veçanta tregojnë se do ta pengojë procedurën penale duke ndikuar mbi dëshmitarët, ekspertët, bashkautorët ose fshehësit. Në fakt, edhe përkundër numrit të vogël të shkeljeve të konstatuara, gjegjësisht nga katër rastet e vërejtura, gjykata në dy raste ka vepruar në kundërshtim me LPP-në, gjegjësisht nuk e ka anuluar paraburgimin pas pranimit të fajit nga ana e personit të akuzuar, megjithatë, ekzistimi i rasteve të këtilla nuk duhet të mbetet i paanalizuar. Kjo për arsye të thjeshtë se në qoftë se udhëhiqemi nga parimi se *iura novit curia*, atëherë mund të përfundojmë se në këto raste paraburgimi, sipas të gjitha rasteve, është përcaktuar mbi më tepër baza, kështu që gjykata në mënyrë racionale ka menduar se kanë ekzistuar bazat e tjera për vazhdimin e masës së paraburgimit edhe përkundër pranimit të fajit nga ana e personit të paraburgosur.

Megjithatë, në qoftë se pranohet ky argument, mbetemi në problemin ekzistues, që u theksua edhe në këtë raport, për bazimin në fakte të vendimeve për përcaktimin e paraburgimit, përcaktimin e tyre, shpeshherë, në mënyrë jokritike dhe të pabazë mbi më tepër baza të nenit 165 të LPP-së, si dhe problemi i theksuar sa i përket arsyetimeve të vendimeve për përcaktimin e masës së paraburgimit të bazuara mbi fakte dhe prova (jo)adekuate, të cilat shënohen në mënyrë (jo)adekuate në ato vendime.

### A është anuluar paraburgimi pas pranimit të fajit?



Të gjitha arsyetimet e tjera të këtyre pohimeve të vëzhguesve do të çonin në përfundimin se bëhet fjalë për mohim të parimit të lartpërmendur të drejtës romake, e me vetë këtë edhe për zbatim jo të drejtë të dispozitave të LPP-së. Aq më tepër, nëse në këto raste është vepruar në këtë mënyrë nga ana e gjykatës, atëherë mbrojtësit, e bile edhe prokurori publik si rojtar i ligjshmërisë,

nuk do të duhej ta tolerojnë veprimin e këtillë, edhe atë duke e kundërshtuar këtë me ankesë, për arsye të thjeshtë se në këto raste rrezikohet e drejta themelore e njeriut – e drejta e lirisë.

## ■ PROCEDURA E PROVAVE

Procedura e provave si segment i shqyrtimit kryesor është paraparë në nenet prej 382 deri në 394 të LPP-së dhe si e tillë në mënyrë të vazhdueshme gjendet edhe në ligj, mirëpo edhe në pyetësonin e sistematizuar të Koalicionit, pas këshillave dhe mundësisë së të akuzuarit që ta pranojë fajin gjatë shqyrtimit. Kjo pjesë e procedurës ka renditje të paraparë në mënyrë të qartë në aspekt të nxjerrjes së provave. Konkretisht, së pari nxirren provat e akuzës dhe ato që janë në korrelacion me kërkesën pronësore-juridike, e pastaj provat e mbrojtjes dhe provat eventuale të akuzës, të cilat do t'i përgënjeshtrojnë provat e mbrojtjes, në formë të replikës, mirëpo edhe provat e mbrojtjes si përgjigje ndaj këtij përgënjeshtrimi, të titulluara si duplika.


Ligji për procedurë penale përcakton 3 mënyra të marrjes në pyetje – të drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësuese. Marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje e bën pala e cila e ka propozuar dëshmitarin, përkatësisht ekspertin ose këshilltarin teknik, marrjen në pyetje në mënyrë të kryqëzuar e bën pala e kundërt, ndërsa marrjen në pyetje në mënyrë plotësuese e bën përsëri pala e cila e fton dëshmitarin, përkatësisht ekspertin dhe pyetjet që parashtrohen gjatë kësaj marrje në pyetje janë të kufizuara në pyetjet e parashtruara gjatë marrjes në pyetje të palës së kundërt. Pas përfundimit të marrjes në pyetje të palëve, kryetari i këshillit (dhe anëtarët e tij) mund të parashtrojnë pyetje.

Në procesin e procedurës së provave, gjykata ka rol ta kontrollojë mënyrën dhe renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe nxjerrjen e provave duke mbajtur llogari për efikasitetin, ekonomizimin e procedurës, si dhe për përcaktimin e të vërtetës. Gjykata në këtë pjesë të procedurës vendos edhe për kundërshtimet e palëve, me ç'rast mund të ndalojë ndonjë pyetje ose përgjigje të pyetjes që është parashtruar më herët, nëse e vlerëson si të palejueshme ose irrelevante për lëndën ose në qoftë se pyetja e përmban edhe pyetjen dhe përgjigjen, kuptohet marrja në pyetje në formë të kryqëzuar paraqet përjashtim nga kjo.

Në bazë të të dhënave të mbledhura, vëzhguesit kanë konstatuar se në këtë pjesë ka respektim të rreptë të dispozitave ligjore, me përjashtim minimal të evidentuar prej 1%, gjegjësisht në vetëm 2 lëndë është evidentuar mospërputhje në renditjen ligjore të nxjerrjes së provave, edhe atë me arsyetimin se bëhet fjalë për ekonomizim të procedurës. Mirëpo, ajo që në perceptimin e gjykatës është ekonomizim i procedurës (në këto 2 raste), paraqet shkelje të të drejtave të të akuzuarit të parapara në LPP.



## A ishte renditja e nxjerrjes së provave sipas renditjes së përcaktuar me ligj




Si risi që është futur në LPP, e që zbatohet momentalisht, është zbatimi i paragrafit 2 të nenit 386 të tij, i cili parasheh dhënie të betimit para fillimit të dëshmisë nga ana e dëshmitarit. Dëshirojmë ta potencojmë faktin se gjykata edhe përkundër betimit të paraparë, e ka për obligim që ta paralajmërojë dëshmitarin për obligimin e tij që t’ia paraqesë gjykatës gjithçka që e ka të njohur dhe që e di, e që ka të bëjë me lëndën, me ç’rast do ta paralajmërojë se dëshmia e rrejtshme është vepër penale. Nga të dhënat të cila i kishim në dispozicion, e pamë se zbatimi i kësaj risie nga ana e gjykatës është në një nivel të kënaqshëm - 69%, edhe pse pa marrë parasysh se a është dhënë betimi ose jo, ai që e jep deklaratën është e paraparë të përgjigjet penalisht në qoftë se si dëshmitar paraqet gjëra të pavërteta, prandaj, ndoshta edhe paraqitet zbatimi jo i detyrueshëm i saj.

Edhe pse për zbatimin e LPP-së, e veçanërisht të risive të futura në të, në periudhën e vacatio legis, mirëpo edhe pas fillimit të zbatimit të tij u mbajtën trajnime të shumta, si nga ana e Misionit të OSBE-së në Shkup, ashtu edhe nga Asociacioni i avokatëve amerikanë në bashkëpunim me Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publikë dhe Odën e avokatëve, megjithatë vërehet se akoma ka nevojë për avancim plotësues të të gjithë aktorëve të përfshirë në procedurë. Kjo posaçërisht ka të bëjë me zbatimin e instituteve të marrjes së drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësuese në pyetje, dhe është rezultat i përvetësimit të pamjaftueshëm të teknikave për zbatimin e tyre nga pjesëmarrësit në procedurë.

Përfundimin e mësipërm e nxjerrim nga të dhënat e fituara pikërisht në pjesën për mënyrat e marrjes në pyetje. Në pyetjet që u formuluan dhe që u implementuan në pyetësor, të cilin vëzhguesit e përdorën si mjet për transmetimin e përvojave dhe të njohurive që i kanë fituar në gjykatë, janë përfshirë një grup pyetjesh që kanë të bëjnë pikërisht me mënyrën dhe teknikat e praktikimit të llojeve të marrjes në pyetje. Në fakt, pyetjet kanë të bëjnë me qartësinë, jodykuptueshmërinë dhe shqyrtimin, gjegjësisht studimin e mjaftueshëm të lëndëve nga ana e palëve në procedurë, mirëpo edhe me rregullat teknike, të cilat gjykata dhe palët në procedurë duhet t’i respektojnë gjatë procedurës.


Në pjesën – a janë të qarta dhe precize pyetjet që i bëhen dëshmitarit/ekspertit gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, nga 126 shqyrtime ku është realizuar marrja e drejtpërdrejtë në pyetje vijmë deri te këto të dhëna:




Nga pyetjet se gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, pala që e ka thirrë dëshmitarin a ka lënë përshtypje se e di çka pyet dhe se e njeh mirë rastin, erdhëm deri te njohuritë se, edhe kur prokurori publik e ka thirrë dëshmitarin, edhe kur mbrojtja e ka thirrë atë, të dyja palët kanë lënë përshtypje se e dinë se çka pyesin dhe se e njohin lëndën, që mund të shihet edhe në grafikët e mëposhtëm.

### Marrja e drejtpërdrejtë në pyetje e realizuar nga

#### Prokurori publik



#### Mbrojtësi




Sa i përket veprimit të gjykatës në procesin e nxjerrjes së provave, është paraparë që ajo ta kontrollojë mënyrën dhe renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe nxjerrjen e provave duke mbajtur llogari për efikasitetin dhe ekonomizimin e procedurës dhe sipas nevojës për përcaktimin e të vërtetës, mirëpo edhe për dinjitetin e palëve dhe të dëshmitarëve në procedurë. Gjatë veprimit, gjykata mund edhe të ndalojë ndonjë pyetje ose përgjigje në pyetje që është parashtruar më parë, nëse vlerëson se ajo është e palejueshme ose irelevante, mund ta refuzojë nxjerrjen e ndonjë prove për të cilën konsideron se është e panevojshme dhe e parëndësishme për lëndën, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka mundësi që pas marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, t'ia ndalojë të drejtën palës kundërshtarë që ta marrë në pyetje në mënyrë të kryqëzuar dëshmitarin kundërshtar. Mirëpo, këtë shkelje të procedurës e hasëm në 2% të të dhënave që u përpunuan.

Kur bëhet fjalë për marrjen e kryqëzuar në pyetje, të dhënat tregojnë se duhet të punohet për përmirësimin e të gjitha palëve të përfshira në procedurë. Në fakt, marrja e kryqëzuar në pyetje është paraparë që të jetë e kufizuar dhe të ndërlihet vetëm me pyetjet të cilat janë parashtruar më


parë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga ana e palës që e ka propozuar. Gjatë monitoringut të realizuar është konstatuar se nga kjo rregull që është paraparë në LPP, ka shmangie prej 18%. Më saktë, gjatë 88 shqyrtimeve të realizuara në të cilat është zbatuar marrja e kryqëzuar në pyetje, në 72 prej tyre, e kjo është 82%, marrja e kryqëzuar në pyetje ka qenë e kufizuar në pyetjet nga marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, ndërsa në 18% të rasteve kjo nuk ka ndodhur. Në situata të caktuara, janë evidentuar raste në të cilat gjykatësit kanë reaguar në mënyrë të drejtpërdrejtë kur është parashtruar ndonjë pyetje, e cila nuk bën pjesë në konceptin e marrjes së kryqëzuar në pyetje, edhe pse është diskutabile se a kanë ata të drejtë të mos lejojnë të parashtrohet ndonjë pyetje pa kundërshtim të rregullt nga pala në procedurë. Në raste të tjera, vetë palët kundërshtare nuk kanë pasur kundërshtime në lidhje me pyetjet, kështu që ato janë qartësuar dhe është dhënë përgjigje në to.

Ajo që le përshtypje nga të dhënat e mbledhura është fakti se mekanizmi i marrjes së kryqëzuar në pyetje më tepër shfrytëzohet nga ana e mbrojtjes se sa nga ana e përfaqësuesve të aktakuzës. Në fakt, siç mund të shihet edhe nga grafikët e mëposhtëm (ku në boshtin horizontal në fund të grafikëve është paraqitur numri i të akuzuarve në procedurë), nga ana e prokurorisë publike gjithsej 64 persona janë marrë në pyetje në formë të kryqëzuar, ndërsa nga ana e mbrojtjes 104 persona. Nga kjo informatë mund të nxirret përfundimi se mbrojtësit e të akuzuarve janë më të vendosur për t'i shfrytëzuar të gjitha resurset që i kanë në dispozicion që ta realizojnë strategjinë e tyre për mbrojtje dhe ta dëshmojnë teorinë e tyre të rastit në interes të të akuzuarve.

**Persona të marrë në pyetje në mënyrë të kryqëzuar nga PP-ja**




**Persona të marrë në pyetje në mënyrë të kryqëzuar nga mbrojtja**



Edhe një tregues se palët në procedurë duhet të punojnë për ta përmirësuar zbatimin e mekanizmit të marrjes së kryqëzuar në pyetje, është fakti se madje në 31% të marrjeve në pyetje nuk janë përdorur pyetjet e mbyllura gjatë procesit të marrjes së kryqëzuar në pyetje. Poashtu janë evidentuar edhe ndërprerje gjatë marrjes së kryqëzuar në pyetje, më saktë në 31% të marrjeve në pyetje, marrja e kryqëzuar në pyetje nuk është zhvilluar në mënyrë të pandërprerë. Ndërsa sipas perceptimit të vëzhguesve, marrja e kryqëzuar në pyetje ka qenë me përqindje të suksesit prej 80%.

Sa i përket zbatimit të kundërshtimeve si mekanizëm taktik për mbrojtjen e strategjisë në rastin konkret, mund të shohim se në fakt edhe prokuroria edhe mbrojtja, praktikisht njësoj e përdorin atë. Mirëpo, në krahasim me të dhënat statistikore nga analiza e përgatitur vitin e kaluar, kur prokuroria i ka shfrytëzuar kundërshtimet në 22% të rasteve, ndërsa mbrojtja në 11%, këtë vit hasim një rënie të vogël të kësaj përqindjeje te prokuroria, ndërsa rritje në anën e mbrojtjes. Më saktë, prokuroria i ka shfrytëzuar kundërshtimet në 20% të shqyrtimeve, ndërsa mbrojtja në 15%, që në fakt çon në afrimin e të zbatimit të këtij mekanizmi.


### Zbatimi i kundërshtimeve gjatë procedurës



Më lartë përmendëm se mundësia që gjykata të parashtrojë pyetje me qëllim që të qartësohen disa fakte dhe paqartësi të dëshmitë, nuk është kufizuar krejtësisht duke pasur parasysh se në ligjin paraprak për procedurë penale kjo mundësi ishte ekskluzivitet vetëm i gjykatës, gjegjësisht vetëm gjykata është ajo që i parashton pyetjet, ndërsa palët në fund të marrjes në pyetje parashtrojnë pyetje me qëllim që të konstatohet ndonjë fakt i lëshuar. Gjykata tani ka mundësi që pas realizimit të marrjes në pyetje nga njëra dhe pala tjetër në procedurë, të parashtrojë pyetje, mirëpo kjo nuk duhet të shndërrohet në marrje të posaçme në pyetje.

Zbatimin e kësaj mundësie mund ta analizojmë nga grafiku i mëposhtëm i cili tregon se gjykata në masë të madhe e shfrytëzon këtë mekanizëm të lejuar të parashtrojë pyetje edhe atë në 48 shqyrtime të ndjekura ose në përqindje në 42% të shqyrtimeve të ndjekura.

### A e shfrytëzon gjykata të drejtën e saj që t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit/ekspertit




Në disa nga pyetësorët madje shkruan se gjykatësit këtë mundësi të tyre e kanë shndërruar në marrje të veçantë në pyetje të dëshmitarëve/ekspertëve. Është e qartë se këto shprehje të vjetra që rrënjët i kanë në sistemin e mëparshëm, akoma gjejnë zbatim, edhe pse sistemi i veprimtimit është diametralisht i kundërt.


Sa i përket nenit 388 paragrafi 2, më saktë përjashtimit nga nxjerrja e drejtpërdrejtë e provave, ku është paraparë që dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në procedurën hetimore dhe dëshmitë e mbledhura në kuadër të veprimeve të mbrojtjes gjatë procedurës hetimore mund të shfrytëzohen gjatë marrjes së kryqëzuar në pyetje ose gjatë përgënjeshtimit të konstatimeve të dhëna ose në

përgjigje të përgënjeshtërimit, me qëllim të vlerësimit të besueshmërisë së deklaratave të dhëna në shqyrtimin kryesor, mund të konstatojmë se në masë të madhe nuk është zbatuar ky përjashtim. Mirëpo, në një përqindje të caktuar, gjegjësisht në 18% të rasteve kur është zbatuar ky përjashtim, kjo është bërë për shkak të dëshmimeve jokonsekuente, gjegjësisht me qëllim të përkujtimit të dëshmisë së dhënë nga dëshmitari që të bëhet diskreditimi i tij, e në këtë rast kur dëshmia që është dhënë gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje ka dalluar nga dëshmia që është dhënë më parë. Poashtu, në përqindje më të vogël është propozuar nga ana e prokurorit publik që të lexohet dëshmia e dëshmitarit, gjegjësisht e të akuzuarit që është dhënë në procedurën paraprake, gjegjësisht në 8% të shqyrtimeve të ndjekura.

### Deklaratat/dëshmitë e shfrytëzuara që janë dhënë në procedurën paraprake



### Leximi i dëshmisë së të akuzuarit në procedurën paraprake




Kur bëhet fjalë për marrjen në pyetje të të akuzuarit gjatë procedurës, me rëndësi është të theksohet se në bazë të nenit 391 paragrafi 1, ai merret në pyetje me propozim të mbrojtjes. Me futjen e kësaj dispozite në ligj, plotësisht hiqet dorë nga parimi i marrjes në pyetje të të akuzuarit me automatizëm në procedurë edhe atë për shkak të nevojës së prokurorisë për ta dëshmuar akuzën. Me eliminimin e këtij sistemi të marrjes në pyetje, të akuzuarit i mundësohet që të mos merret në pyetje në procedurë, gjegjësisht kjo i lihet në dispozicion mbrojtjes, e jo si më parë që të detyrohet ta shfrytëzojë të drejtën e heshtjes, kur konsideron se nuk duhet të japë dëshmi, e me këtë të imponohet një fotografi e gabuar për të, më shpesh se është fajtor dhe të nxirren përfundime të parakohshme nga ana e gjykatës për të dhe për veprimet e tij.

Në qoftë se nga ana e mbrojtjes është dhënë propozim për marrjen në pyetje të të akuzuarit, ai gjatë shqyrtimit merret në pyetje në përputhje me rregullat që zbatohen dhe që vlejné për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, gjegjësisht ekspertëve në aspekt të llojeve të marrjes në pyetje, me atë që i akuzuari nuk mund të refuzojë të përgjigjet në pyetjet që parashtrohen sipas konceptit të marrjes së kryqëzuar në pyetje.

Nga të dhënat e mbledhura nga ky vit fituam statistikë se i akuzuari në procedurë është marrë në pyetje në 65% të shqyrtimeve të ndjekura, që tregon se ka rritje në krahasim me të dhënat nga vitet e mëparshme, të cilat tregojnë se kjo përqindje në vitin 2015 ka qenë 53%, ndërsa në vitin 2014, 50%.


### A është marrë në pyetje i akuzuari



## ■ GJYKIMI I DREJTË – barazia e armëve

Sa i përket vlerësimin të barazisë së armëve të palëve, mund të përfundohet se vëzhguesit e mbajnë qëndrimin e viteve të kaluara. Respektivisht, sa i përket pyetjeve se a janë trajtuar palët në mënyrë të barabartë nga ana e gjykatës (grafiku nr. \_\_\_) dhe a i ka pasur mbrojtja mundësitë e njëjta sikurse edhe prokuroria gjatë propozimi të provave (tabela nr. \_\_\_), vëzhguesit janë përgjigjur pozitivisht në përqindje shumë të lartë prej 99%. Gjegjesisht, nga përgjigjet e dhëna, vetëm në tre, respektivisht në dy raste janë përgjigjur negativisht në këto pyetje.


### A janë trajtuar mbrojtja dhe i akuzuari në mënyrë të barabartë nga ana e gjykatës?



Në këtë drejtim, mund të konstatohet se gjatë shqyrtimit kryesor kur edhe më së shumti vjen në shprehje mundësia për t'i kundërshtuar armët para gjykatës, gjykata në masë të madhe palët i trajton në mënyrë të barabartë, gjegjesisht u jep mundësi të barabartë të prezantojnë prova. Me këtë rast, vërejtjet e konstatuara<sup>9</sup> në drejtim të kufizimit të të drejtës së barazisë së armëve me gjasë janë rezultat i mundësive të pabarabarta të palëve para së gjithash gjatë procedurës paraprake, kur edhe mblidhen provat, prandaj në mënyrë analoge, në qoftë se palët nuk kanë mundësi që disa prova t'i mblidhin gjatë hetimit, as që do të kenë mundësi që ato t'i propozojnë që të nxirren gjatë shqyrtimit kryesor. Në këtë mënyrë, në fakt problemet në aspekt të barazisë së armëve të palëve si pjesë e parimit për gjykim të drejtë, ka mundësi të jenë të maskuara në qoftë se ato analizohen vetëm nëpërmjet vlerësimit të tyre për rolin e gjykatës gjatë shqyrtimit kryesor.

<sup>9</sup> Shih: Kallajxhiev G., Denkovska M., Analizë e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2015, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, 2015, fq. 52.

### A i kishte mbrojtja mundësitë e njëjta sikurse edhe prokuroria për propozimin e provave?




### E drejta/parimi i gjykimit publik

Sa i përket asaj se a janë gjykimet publike, si një nga parimet themelore të procedurave gjyqësore, mund të konstatojmë se vëzhguesit nuk kanë vërejtur veprime të mëdha jokoneskuente gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së. Kështu, vëzhguesit kanë konstatuar se edhe në rastet kur publiku ka qenë i përjashtuar, kjo është bërë në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Ajo që është interesante në aspekt të mbrojtjes së të drejtës për gjykim publik është ngecja e qartë në aspekt të publikimit të kohës dhe të lëndëve që udhëhiqen në gjykata. Sa i përket kësaj pyetjeje kemi përkeqësim të vazhdueshëm, kështu që në krahasim me vitin e kaluar, kur para gjykatës nuk është publikuar koha dhe vendi i gjykimit vetëm në 12% të lëndëve të vëzhguara<sup>10</sup>, këtë vit kemi përkeqësim, edhe atë në pothuajse 20% të lëndëve të analizuara. Shkaqet për këtë përkeqësim të të drejtës për informim të publikut për atë se cilat procedura mbahen në objektet e gjykatave, edhe atë kur dhe ku, mund të gjenden në faktet se kemi mirëmbajtje të keqe të tabelave të informacionit nëpër gjykata; se thjeshtë në buxhetet e gjykatave kemi planifikim të keq sa i përket mirëmbajtjes së rregullt të këtyre sistemeve për njoftim ose se shërbimet administrative të gjykatave nuk janë të njoftuara sa duhet me rëndësinë e informimit në kohë për seancat që zhvillohen nëpër gjykata, dhe për këtë arsye edhe e anashkalojnë këtë obligim të tyre gjatë ushtrimit të rregullt të kompetencës gjyqësore.

### A ishte publikuar koha dhe vendi i gjykimit në tabelën jashtë gjykatës?



<sup>10</sup> Po aty, fq. 54.

## E drejta/parimi i paanshmërisë

Njëra nga të drejtat esenciale në kuadër të të drejtës për gjykim korrekt dhe procedurë të drejtë padyshim është edhe e drejta për paanshmëri të gjykatës. Analiza e mbrojtjes së kësaj të drejte nëpër procedurat gjyqësore u bazua në një grup pyetjesh që kishin të bëjnë me përjashtimin e gjykatësve, që padyshim është njëri nga mekanizmat në kushte të anshmërisë së dukshme të gjykatës ndaj ndonjëres palë. Me këtë rast, nga seancat e vëzhguara, vëzhguesit nuk kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti ku palët kanë kërkuar përjashtim të gjykatësve. Nga këto të dhëna mund të konstatojmë se gjykata i ka zbatuar në mënyrë adekuate dhe u ka kushtuar vëmendjes dispozitave me të cilat në LPP është paraparë përjashtimi i detyrueshëm i gjykatësve, si dhe se e ka udhëhequr procedurën në mënyrë adekuate, pa lënë me këtë rast mundësi që të dyshohet në paanshmërinë e saj, si bazë për përjashtim fakultativ të gjykatësve.

Interesante është informata sipas të cilës vëzhguesit në shtatë seanca kanë vërejtur se gjykatësit kishin mendim të formuar paraprakisht sa i përket lëndës. Posaçërisht e rëndësishme është informata se gjatë tre viteve të fundit, ky numër rritet në mënyrë të vazhdueshme, gjegjësisht nga vetëm tre raste para dy vitesh, kemi pesë raste në vitin e kaluar dhe shtatë raste këtë vit. Me këtë rast është interesante të theksohet se këto lëndë më shpesh kanë të bëjnë me rastet kur të akuzuarit kanë bërë pranim të fajit. Kështu që edhe përkundër numrit të vogël të rasteve të evidentuara, gjegjësisht vetëm shtatë nga gjithsej 450 seanca të vëzhguara, megjithatë, praktika e këtillë ofron një arsye për brengosje, për shkak se në këto raste, në vend të vlerësimit aktiv të pranimit të fajit nga ana e gjykatës, kemi situatë kur gjykata thjesht mezi pret që i akuzuari ta pranojë fajin që ta konfirmojë qëndrimin e saj në lidhje me të. Aq më tepër, në këto raste do të duhej të rivlerësohet edhe roli i mbrojtësit të personit të akuzuar, gjegjësisht a e ka këshilluar klientin e tij dhe në çfarë mënyre, në lidhje me pranimin e fajit. Nëpërmjet rolit të këtillë të gjykatës vihet në pikëpyetje i gjithë mekanizmi garantues dhe mbrojtës i saj. Si dalje eventuale nga kjo situatë, me gjasë mund të shërbejë reforma e ardhshme eventuale e dispozitave të LPP-së, ku do të futej një seancë e veçantë për vlerësimin dhe përcaktimin e sanksionit penal, dhe me këtë edhe në këto raste, para gjykatës do të duhej të nxirren prova plotësuese me të cilat do të vërtetohej fjaji i të akuzuarit që është konstatuar nga ana e gjykatës nëpërmjet pranimit të fajit nga i akuzuari.

Me këtë rast, nga të dhënat mund të përfundojmë se gjykata ka qenë e njëanshme në pesë raste, ndërsa në dy raste e ka frikësuar personin e akuzuar. Frikësimi që është bërë në këto raste, siç sqaruan në mënyrë plotësuese vëzhguesit tanë, u zbulua në atë mënyrë që gjykata e ka favorizuar pranimin e fajit nga personi i akuzuar me atë që gjatë sqarimit të dispozitave të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së sanksionit penal, ka përdorur fjalë me anë të të cilave e ka stimuluar pranimin e fajit dhe e ka potencuar faktin se në qoftë se e pranon fajin, i akuzuari do të fitojë sanksion më të lehtë, në krahasim me shqyrtimin kryesor, kur do të merrte sanksion më të lartë.


Konsiderojmë se në këto raste ndoshta mund të bëhet fjalë edhe për përzgjedhje të gabuar të fjalëve nga ana e gjykatës gjatë sqarimit të pasojave nga pranimi i fajit, me qëllim që, në njëfarë mënyre, edhe t'i ndihmohet të akuzuarit. Megjithatë, konsiderojmë se veprimi i këtillë i gjykatës do të duhej të minimizohet dhe të eliminohet nëpërmjet trajnimit adekuat të gjykatësve. E gjithë kjo me qëllim që të shmangët praktika e gjykatës kur vetëm njoftimi me pasojat nga pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, do të mund të interpretohej nga ana e të akuzuarit apo pjesëmarrësit në procedurë, si njëfarë favorizimi të pranimit të fajit nga ana e gjykatës. Në këtë mënyrë pranimi i fajit do të bëhej vetëm si rezultat i vullnetit të lirë të personit të akuzuar dhe ai nuk do të ngarkohej me asnjë lloj iniciative apo presioni delikat nga ana e gjykatës.

Kur bëhet fjalë për trajnimin plotësues të gjykatësve, padyshim duhet potencuar edhe trajnimin e gjykatësve për mënyrën e komunikimit ndërmjet gjykatës dhe palëve, veçanërisht duke e pasur parasysh faktin se pikërisht komunikimi i këtillë joadekuat ex-parte ka mundësi që në



masë të madhe ta dëmtojë përshtypjen për (pa)anshmërinë e gjykatës te i akuzuari ose te publiku në përgjithësi. Kjo përshtypje bazohet në faktin se vëzhguesit e kanë vërejtur këtë praktikë në 12 seanca, që paraqet rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin e kaluar kur ky komunikim është evidentuar vetëm në 5 raste.

### A kishte komunikim joadekuat ex-parte?




Shkaqet për nevojën për trajnim plotësues të gjykatësve paraqiten për faktin se në kushte të komunikimit joadekuat ex-parte gjykata rrezikon të konsiderohet si e afërt me ndonjërin nga palët, me çka te publiku i gjerë humbet përshtypja për paanshmërinë e saj. Në fakt, ndonjëherë madje edhe mbrojtësit përpiqen dhe/ose e keqpërdorin këtë komunikim joadekuat me gjykatën, me qellim që para klientëve të tyre të paraqiten sikur kanë raporte/kontakt të afërt me gjykatësit, që në atë mënyrë t'i arsyetojnë premtimet, jo gjithmonë reale, që ua japin klientëve të tyre për rezultatin përfundimtar të procedurës penale.

### Supozimi i pafajësisë

Ngushtë e lidhur me anshtmërinë dhe çështjet që u analizuan më lartë është edhe çështja e supozimit të pafajësisë. Kështu, për dallim nga viti i kaluar, edhe këtë vit kemi përkeqësim të gjendjes që është shprehur nëpërmjet të dhënave për perceptimin e vëzhguesve. Në fakt, vëzhguesit kanë vërejtur shkelje të kësaj të drejte të të akuzuarit në tetë raste ose në tre për qind të rasteve, që është tre herë më shumë se sa vitin e kaluar, kur shkelja e kësaj të drejte ishte vërejtur vetëm në një për qind të rasteve<sup>11</sup>. (tabela \_\_).

### A ekzistonte diçka që do të sugjeronte se nuk është respektuar parimi i supozimit të pafajësisë?



11 Po aty, fq. 60.

Ky konstatim, në qoftë se ndërlihet me të dhënat paraprake sa i përket paanshmërisë së gjykatës, ku vëzhguesit tanë kanë konstatuar se gjykata ka qenë e njëanshme në 7 raste, ndërsa në tetë raste është shkelur e drejta e supozimit të pafajësisë së personit të akuzuar, mund të çojë në përfundimin se në të gjitha rastet e evidentuara gjykata ka qenë e njëanshme në dëm të personit të akuzuar. Pasojat nga ky përfundim nuk ka nevojë të komentohen. Për këtë qëllim konsiderojmë se duhet të realizohet trajnim plotësues për gjykatësit sa i përket rolit të tyre gjatë procedurës për vlerësimin e pranimit të fajit nga personi i akuzuar. Megjithatë, një dozë optimizmi jep numri i vogël i lëndëve të evidentuara, që çon në përfundimin se kjo dukuri nuk është shumë e përhapur te gjykatësit dhe se me lehtësi mund të pengohet dhe të largohet.

## E drejta për mbrojtje

E drejta për mbrojtje u analizua nëpërmjet një grupi të pyetjeve që kishin të bëjnë me këshillën për të drejtat e të akuzuarit, efikasitetin e mbrojtësve në realizimin e teorisë së tyre të rastit gjatë shqyrtimit kryesor, si në aspekt të qasjes së mbrojtjes deri te të gjitha provat, kohës adekuate për përgatitje, ashtu edhe në aspekt të kufizimeve eventuale të kësaj të drejte dhe/ose kufizimeve të të drejtës për komunikim me mbrojtësin e tij për personat e akuzuar që janë të paraburgosur.

Sa i përket efektivitetit të të drejtës për mbrojtje, vëzhguesit tanë kanë vërejtur se në 19 raste, gjegjësisht në 12% të përgjigjeve në këtë pyetje, mbrojtësit nuk kanë qenë në lartësi të detyrës së tyre sa i përket sigurimit të mbrojtjes efikase dhe profesionale të klientëve të tyre. Në këtë drejtim, edhe përkundër përqindjes relativisht të ulët të numrit të përgjithshëm të lëndëve të vëzhguara, megjithatë, jemi të detyruar të përmendim se mbrojtësit, e poashtu edhe avokatët si profesionistë të fushës së tyre, janë të obliguar që të kujdesen për të siguruar trajnime të vazhdueshme dhe avancim të standardeve profesionale për anëtarët e tyre. Mu për këtë, duhet të bëhen analiza të vazhdueshme për efikasitetin dhe profesionalizmin e mbrojtësve<sup>12</sup>, veçanërisht në kushte kur është futur sistemi akuzativ, i cili shihet qartë gjatë shqyrtimit kryesor, në të cilin nga veprimet e mbrojtjes në masë të madhe varet edhe rezultati përfundimtar i procedurës penale. Argument plotësues për këtë fakt është edhe trendi brengosës i rritjes në krahasim me vitin e kaluar, edhe atë prej 6%<sup>13</sup> në 12% nga pyetësorët e plotësuar që u analizuan. Gjatë kësaj, fillimisht fjalën e kemi për formësimin adekuat të teorisë së rastit të mbrojtjes, duke vazhduar me propozimin e provave adekuate e deri te roli i tyre aktiv në përgënjeshtrimin e provave të akuzës nëpërmjet pyetjeve të kryqëzuara dhe aftësisë për të parashtruar kundërshtime te gjykata për mospranimin e pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorisë gjatë dëshmitarëve.

Me këtë rast, sa i përket efikasitetit të mbrojtjes së dhënë, në mbrojtje të tyre, mbrojtësit më shpesh i kanë theksuar argumentet se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen e tyre ose se janë ballafaquar me kufizime të caktuara gjatë kontaktit me klientët e tyre. Paqartësi të këtilla vëzhguesit kanë vërejtur në katër raste.


Nga ana tjetër, mbrojtësit, tradicionalisht, si probleme për sigurimin e mbrojtjes efikase dhe efektive të klientëve të tyre i kanë theksuar: kufizimin e qasjes në të gjitha provat me të cilat ka disponuar prokuroria (në 6 raste), mosdorëzimin e provave (në 3 raste) dhe 5 raste të tjera (Grafiku

12 Rëndësia e rolit të mbrojtësit gjatë procedurës penale akuzative, e veçanërisht gjatë procedurës për marrëveshje është potencuar në shumë hulumtime empirike që në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar në SHBA dhe Angli – shih më tepër, për shembull: Albert Alschuler, *The Defense Attorney's Role in Plea Bargaining*, 84

13 Ибид, стр. 68.

nr.) kur mbrojtësve u është penguar kjo e drejtë. Vërehet se këtë vit kemi rritje drastike të këtyre ankesave nga ana e mbrojtësve, edhe atë nga dy raste të evidentuara vitin e kaluar në katërmbëdhjetë raste këtë vit, apo shtatë herë më tepër<sup>14</sup>.

### A reagoi mbrojtja për shkak se



Kjo do të thotë se qëllimet e dëshiruara të reformës së procedurës penale<sup>15</sup> që janë zbatuar me sjelljen e LPP-së në vitin 2013, nuk kanë pasur jehonë adekuate në praktikë, prandaj, sipas analogjisë, do të duhej të mendohet për ndryshimin e dispozitave të LPP-së, me qëllim të përfshirjes së mekanizmave garantues për mbrojtësit me qëllim të përforsimit të obligimit që mbrojtja të ketë qasje në të gjitha provat e akuzës. Kjo do të mundësohej duke e futur ndalesën për nxjerrjen e provave që nuk u janë dorëzuar mbrojtësve, e që janë në dëm të të akuzuarit ose duke e futur obligimin për nxjerrjen e provave që janë në dobi të mbrojtjes, e për të cilat mbrojtja thotë se i posedon prokuroria, mirëpo të cilat nuk u janë dhënë mbrojtësve. Pastaj, do të duhej të ndalohet praktika e qasjes së kufizuar të mbrojtësve në prova të caktuara, me atë që nuk u lejohet kopjimi ose (ri)incizimi i tyre. Gjegjësisht, në rastet kur provat vetëm u prezantohen mbrojtësve në zyrat e prokurorisë, pa u mundësuar mbrojtësve që këto prova t'i fotokopjojnë ose t'i kopjojnë, ose kur ky aktivitet është i ngarkuar me shpenzime shumë të larta joadekuate për kopjim ose shumëzim elektronik në ndonjë medie tjetër elektronike për bartjen e të dhënave.

Poashtu, konsiderojmë se është e nevojshme të ndryshohen dhe të zgjerohen afatet ligjore sipas të cilave i dyshuari dhe mbrojtësi gjatë hetimit kanë të drejtë të dorëzojnë dokumente të caktuara personale, prova ose të kërkojnë nga prokurori të realizojë veprime të caktuara hetuese dhe të sigurojnë prova të caktuara, në kuptim të paragrafit 4 të nenit 302 të LPP-së, si dhe të parashihet afat i veçantë gjatë shqyrtimit kryesor që do të paraqiste kohë adekuate për përgatitjen e mbrojtjes në lidhje me provat e reja që janë fituar nga prokuroria.

## SHQIPTIMI DHE PUBLIKIMI I AKTGJYKIMIT

Pas nxjerrjes së të gjitha provave, gjegjësisht pas përfundimit të procedurës së provave dhe pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, në bazë të LPP-së, me radhë vijnë dispozitat që kanë të bëjnë me aktgjykimin. Ligji ynë për procedurë penale njih 3 lloje të aktgjykimeve edhe atë: refuzues – me


<sup>14</sup> Po aty, fq. 70.

<sup>15</sup> Shih: Krapac D., Kambovski V., Buzharovska G., Kallajxhiev G., Strategjia për reformë të të drejtës ndëshkuese, Ministria për Drejtësi, Shkup, 2007, gjendet në: [http://arhiva.vlada.mk/registar/files/strategjia\\_kazneno.pdf](http://arhiva.vlada.mk/registar/files/strategjia_kazneno.pdf)

të cilin refuzohet aktakuza, lirues – me të cilin i akuzuari lirohet nga aktakuza dhe dënues – me të cilin i akuzuari shpallet fajtor.


Vëzhguesit e Koalicionit nuk kanë hasur në aktgjykime refuzuese dhe liruese, mirëpo gjatë procedurës janë hasur situata ku është tërhequr aktakuza nga ana e prokurorit. Në 9 raste nga lëndët e ndjekura, aktakuza është tërhequr me atë që kjo është bërë në 3 lëndë ku si bazë për ndjekje është kryer vepra penale “Lëndim trupor”, në dy lëndë “Vjedhje e rëndë” dhe nga një me vepra penale “Detyrim”, “Rrezikim i sigurisë”, “Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në komunikacion” dhe “Kryerje e transportit publik pa posedim të licencës”.

### Aktakuzat e tërhequra sipas veprave penale




Dispozitat e LPP-së parashohin se pas shqiptimit të aktgjykimit ai duhet të publikohet menjëherë, me atë që në qoftë se gjykata nuk ka mundësi që atë ta shqiptojë ditën e njëjtë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, ta prolongojë edhe publikimin e aktgjykimit, mirëpo më së shumti për 3 ditë. Publikimi i aktgjykimit është paraparë që të bëhet nga ana e gjykatës (kryetari i këshillit ose gjykatësi individual) edhe atë në prezencë të palëve, përfaqësuesve të tyre ligjor, të autorizuarve, mbrojtësve, me ç’rast shqiptimi i tij lexohet publikisht dhe shkurtimisht përmenden shkaqet për sjelljen e tij. Në arsyetimin e shkurtër, gjykata jep një pasqyrë të veprës penale për të cilën “ngarkohet” dhe tashmë është dënuar (me aktgjykimin) i akuzuari, si dhe të provave të prezantuara.

### Publikimi i aktgjykimit




### A bëri gjykata një pasqyrë të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari dhe të provave të prezantuara



Nga të dhënat e përpunuara të vëzhguesve, vërejtëm se në 74% të rasteve, aktgjykimi është publikuar, kundrejt 26% kur kjo nuk është bërë, mirëpo edhe se në shqyrtimet në të cilat është publikuar aktgjykimi, në 41 rast gjegjësisht shqyrtim, gjykata ka bërë pasqyrë të veprës penale dhe të provave, në 3 shqyrtime këtë e ka bërë pjesërisht, ndërsa në 9 shqyrtime aspak nuk i ka kush-tuar kohë dhe vëmendje kësaj. Në krahasim me të dhënat statistikore të vitit të kaluar, të cilat u mblodhën për nevojat e analizës së njëjtë, mund të vërejmë se ka trend të rritjes së përqindjes së aktgjykimeve që nuk janë shqiptuar publikisht dhe nuk janë publikuar. Konkretnisht, në bazë të të dhënave të vitit të kaluar, gjykata në 88% të rasteve aktgjykimin e ka shqiptuar publikisht, kundrejt 12% kur nuk e ka bërë këtë.


Mirëpo, ajo që është me rëndësi për ne është se në bazë të nenit 406 të LPP-së, pas publikimit të aktgjykimit, kryetari i këshillit ose gjykatësi individual do t'i këshillojë palët për të drejtat për ankesë, si dhe për të drejtën për të marrë përgjigje për ankesën. Në qoftë se eventualisht është shqiptuar dënim me kusht, gjykata e ka për obligim që të paralajmërojë për rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilave doemos duhet t'u përmbahet i akuzuari, që tashmë është i dënuar.

### A i janë sqaruar të akuzuarit kushtet për ankesë



Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, në 24% të rasteve, që përkon me 15 shqyrtime të vëzhguara, gjykata nuk i ka sqaruar kushtet për ankesë edhe pse e ka pasur për obligim ta bëjë këtë, pa marrë parasysh se a ka qenë i akuzuari me mbrojtësin e tij në shqyrtim ose jo. Ndërsa në 76% të shqyrtimeve, përqindje kjo që përkon me 48 shqyrtime të vëzhguara, gjykata ka vepruar në përputhje me ligjin. Do të dëshironim të theksojmë se kjo informatë nuk do të ishte edhe aq për t'u habitur në qoftë se do të kishte informatë se në një numër të madh të rasteve kur gjykata nuk i ka sqaruar kushtet për ankesë, i pranishëm ka qenë mbrojtësi i të akuzuarit, i cili si profesionist ka mundësi që më vonë ta këshillojë klientin e tij për procesin e procedurës për ankesë, mirëpo nuk kemi një informatë të këtillë kështu që nuk mund të japim komente plotësuese.

Në qoftë se i analizojmë dhe i krahasojmë të dhënat që kanë të bëjnë me numrin e aktgjykimeve (dënuese) kundrejt numrit të aktgjykimeve ku ka praninë të fajit mund të vijmë deri te përfundimi i mëposhtëm:



Është e dukshme se instituti i pranimi të fajit gjatë procedurave është zbatuar në masë të madhe. Të dhënat tregojnë se ka përqindje të lartë prej 64% nga numri i përgjithshëm i lëndëve të ndjekura, që ka të bëjë pikërisht me pranimin e fajit në procedurë, kundrejt atyre me aktgjykime të rregullta (dënuese) prej 36%. Kjo, në përgjithësi, është rezultat i nevojës dhe i angazhimit të mbrojtësve të të akuzuarve për dënime më të vogla, duke pasur parasysh faktin se gjatë pranimi të fajit, në mënyrë proporcionale zvogëlohet edhe lartësia e dënimit, e poashtu edhe i qëndrimeve dhe i perceptimeve të gjykatave, të krijuara me vite, sa i përket të akuzuarve dhe pashmangshmërisë për dënimin eventual të tyre, dhe në bazë të kësaj edhe të akuzuarit janë dënuar më shumë ose më pak, mirëpo megjithatë janë dënuar.

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME:

- Vazhdojnë të ekzistojnë problemet me dërgimin jo të rregullt, që për pasojë ka mosparaqitjen e palëve, ekspertëve dhe dëshmitarëve në shqyrtimet gjyqësore.

**Rekomandimi:** duhet të rishqyrtohet dhe të përmirësohet sistemi i dërgimit deri te dëshmitarët dhe të futet në përdorim sistem efikas për dërgim elektronik deri te palët dhe ekspertët, si dhe të bëhet inkuadrimi aktiv i MPB-së për sigurimin e të dhënave personale.

- Problematike është praktika e mosshoqërimit të të akuzuarve dhe të personave të paraburgosur nga institucionet ndëshkuese-përmirësuese. Shkaqet më shpesh janë si rezultat i: problemeve të koordinimit me sistemin për evidencë të shoqërimit të personave të privuar nga liria, ose i mungesës së mjeteve financiare ose automjeteve për shoqërimit e këtyre personave.

**Rekomandimi:** përmirësimi i koordinimit ndërmjet organeve dhe përmirësimi i sistemi i AKMIS, me qëllim të eliminimit të problemeve të konstatuara. Ndarje reale e mjeteve buxhetore për funksionimin normal të gjykatave.

- Në pjesën e fjalimeve hyrëse, është konstatuar praktika e përgatitjes ose prezantimit joadekuat të përmbajtjes së tyre, me ç'rast ato shndërrohen në lexim të aktakuzës, nxjerrjes së provave, potencim të dënimit të mëparshëm të personit të akuzuar, pa e paraqitur gjatë kësaj teorinë e rastit dhe pa i përcaktuar çështjet juridike që do të shqyrtohen.

**Rekomandimi:** Mbajtja e trajnimit plotësues për subjektet e përfshira në procedurën penale sa i përket zbatimit të drejtë të dispozitave të LPP-së që kanë të bëjnë me fjalimet hyrëse.

- Edhe pse është institut i ri, pranimit i fajit është i përfaqësuar në mënyrë adekuate në sistemin nacional të të drejtës ndëshkuese dhe ai nuk varet nga lloji i veprës penale, edhe pse më shpesh zbatohet për veprat më të lehta penale. Nga të dhënat e fituara mund të nxirret përfundimi se ky institut është i njohur nga ana e subjekteve në procedurën penale si mjet efikas për përfundim të shpejtë, efikas dhe efektiv të procedurave penale.
- Gjatë vlerësimit të pranimit të fajit është vërejtur praktikë joadekuate nga ana e gjykatave kur janë miratuar pranime të mangëta të fajit, gjegjësisht situata kur gjykatat nuk e kanë vërtetuar plotësisht se pranimet e fajit a janë bërë me vetëdije dhe/ose vullnetarisht.

**Rekomandimi:** ka nevojë për trajnim plotësues të gjykatësve me qëllim të mbrojtjes proaktive të drejtësisë në kushte kur është bërë pranimit i fajit gjatë shqyrtimit kryesor, gjegjësisht të rritet roli i tyre aktiv gjatë vlerësimit të pranimit të fajit.

- Gjatë vlerësimit të pranimit të fajit është vërejtur praktikë joadekuate nga ana e gjykatave për miratimin e pranimeve të fajit pa mbështetje të mjaftueshme me fakte. Gjegjësisht, gjatë procedurës së reduktuar të provave, nxirren prova vetëm për dënimin e mëparshëm të personit të akuzuar.

**Rekomandimi:** reformë e LPP-së duke futur autorizim për gjykatën që të kërkojë nga palët të nxjerrin prova në sasi dhe cilësi që janë të nevojshme për gjykatën që të mund plotësisht ta miratojë pranimin e fajit të të akuzuarit ose duke futur dispozita për mbajtjen e seancës së veçantë për përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së sanksionit.

- Zbatimi i rrallë i masave për sigurimin e prezencës së personit të akuzuar, të cilat mund të jenë alternativë e paraburgimit, efikasiteti i të cilave është i pranuar në sistemet e tjera më të zhvilluara të drejtës ndëshkuese.

**Rekomandimi:** futja e mekanizmit adekuat për zbatimin dhe kontrollin e masave më të lehta, i cili gjykatës do t'i ofronte të dhëna dhe garanci të mjaftueshme për zbatimin e tyre efikas. Këto mekanizma mund të futen nëpërmjet ndryshimeve ligjore në LPP dhe në Ligjin për shërbimin e provës duke i inkorporuar këto masa në kompetencat e shërbimeve të provës.

- Është evidentuar jokonsekuencë në renditjen ligjore të nxjerrjes së provave me arsyetimin se bëhet fjalë për ekonomizim të procedurës.

**Rekomandimi:** të ndiqen dispozitat e LPP-së sa i përket renditjes së nxjerrjes së provave.

- Është konstatuar përqindje e lartë e zbatimit jo të rregullt të dispozitave të LPP-së që kanë të bëjnë me marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësuese të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, që është rezultat i mospërvetësimit të duhur të teknikave dhe zbatimit të tyre nga ana e pjesëmarrësve në procedurë.

**Rekomandimi:** ka nevojë për trajnim plotësues të palëve në procedurën penale për zbatimin e rregullt të këtyre instituteve.

- Zbatimi i shpeshtë, pa arsye, i autorizimit të gjykatës që në fund të marrjes në pyetje të dëshmitarëve/ekspertëve të parashtrorë pyetje, e madje në raste të caktuara ky aktivitet i gjykatës kalon në marrje të veçantë në pyetje.

**Rekomandimi:** reformë e dispozitave të LPP-së me qëllim të eliminimit të këtij autorizimi të gjykatës.

- Janë konstatuar lëshime të caktuara nga ana e shërbimeve administrative të gjykatave, me atë që nuk janë publikuar në mënyrë adekuate vendi dhe koha e mbajtjes së seancave të lëndëve gjyqësore.

**Rekomandimi:** puna e gjykatave të bëhet publike dhe transparente duke e publikuar kohën dhe vendin e seancave, si në ueb-faqet e gjykatave ashtu edhe në kuadër të ndërtesave të gjykatave.

- Përsëri është evidentuar praktika e shkeljes së të drejtave të procesit të mbrojtjes duke e kufizuar qasjen te provat ose duke e vështirësuar shikimin e tyre.

**Rekomandimi:** përmirësimi i dispozitave të LPP-së me qëllim të eliminimit të praktikës së qasjes së kufizuar të mbrojtësve deri te provat e prokurorisë, si dhe rishqyrtimi i rregullave të miratuara për lartësinë e kompensimit të shpenzimeve për qasje dhe kopjim të provave.

- Ka trend të rritjes së përqindjes së aktgjykimeve që nuk janë shqiptuar publikisht dhe nuk janë publikuar.

**Rekomandimi:** zbatimi konsequent i dispozitave të LPP-së për shqiptimin publik dhe publikimin e aktgjykimeve.